

GYKATA E QARKUT TË PRISHTINËS

Data: 26 Nëntor 2010

Rasti: P Nr. 555/06.

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me trupin gjykues të përbërë nga:

Gjyqtari i EULEX-it, Francesko Florit, në cilësinë e Kryetarit të Trupit Gjykues

Gjyqtarja e EULEX-it, Karen Asphaug, anëtar i trupit gjykues

Gjyqtari vendor, z. Ramadan Gudaci, anëtar i trupit gjykues.

Të ndihmuar nga procesmbajtësi i gjykatës Stephen Parkinson

Në gëshjen penale kundër:

Mujë Ukaj, i lindur më 21 Janar 1958 në Zallq, komuna e Istogut, me banim në të njëjtin vend, shqiptar i Kosovës,

Nexhat Shatri, i lindur më 7 Shkurt 1948 në fshatin Tomoc, komuna e Istogut, aktualisht me banim në Bregun e Diellit 2, 34/33, Prishtinë, shqiptar i Kosovës

Qefser Baholli, i lindur më 20 Shkurt 1961 në Prishtinë, ku ai aktualisht banon, në rrugën Lidhja e Prizrenit 2, shqiptar i Kosovës.

Blerim Svirca, i lindur më 10 Qershor 1971 në Prishtinë, ku ai aktualisht banon në A3 Ndërtesën Kalabritja A3, shqiptar i Kosovës.

Përkatesisht të akuzuar për veprat penale të

Mujë Ukaj, Nexhat Shatri, dhe Baholli Qefser:

Supërdorim i Pozitës Zyrtare ose Autorizimit në kundërshtim me Nenin 339 KPPK-së, të gjithë si bashkë-kryes në përputhje me Nenin 23

Blerim Svirca:

Shpërlarja e Parave në kundërshtim Rregullorës së UNMIK-ut 2004/2, Neni 10

Pas seancave gjyqësore të mbajtura më 7, 8, 17 Shtator, më 5, 7 Tetor, më 3, 8 dhe 26 Nëntor 2010, në prani të Prokurorit z. Nazmi Mustafa, të akuzuarve të përmendura më lart dhe avokatëve mbrojtës të tyre;

Pas shqyrtimit të trupit gjykues të mbajtur më 26 Nëntor 2010;

bazuar në Nenin 390 dhe 391 (1) të Kodit të Procedurës Penal të Kosovës (KPPK)

Name: *A Svirca final Judgment_EA*

Translated by: *IV 1- Phone: 4080*

17, VR 18-34

Page: 1 of 36

publikisht dhe në pranimë e të akuzuarve, avokatët e tyre mbrojtës dhe të Prokurorit Publik lëshon si në vijim këtë:

AKTGYKIM

Pas rikuatifikimit të akuzave,

Mujë Ukaj dhe Nexhat Shatri janë shpallur fajtorë për vepra penale të Aktivitetit të Papërgjegjshëm Ekonomik, në kundërshtim me Nenin 233 KPK, krimi i kryer në bashkë-kryerje, ish nen. Neni 23 i KPK-së;

Në mënyrë të veçantë, sepse në cilësinë e tyre përkatëse të personave përgjegjës në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës (Mujë Ukaj, si Sekretar i Presidentit dhe Zyrтари Autorizues dhe Nexhat Shatri, si shëf i Departamentit të Prokurimit në Zyrën e Presidentit), **Mujë Ukaj dhe Nexhat Shatri kanë vepruar në mënyrë të papërgjegjshme dhe për këtë arsye kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material në Zyrën e Presidentit të Kosovës. Në veçanti, ata kanë anashkalluar çdo formë të konsiderueshme të zellit të duhur dhe të kontrollit në procedurën e blerjes së automjeteve të blinduara dhe të pa-blinduara të përshtuara në aktakuzën e ndryshuar;**

Blerim Svirca shpallet fajtor për veprën penale të **Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose Autorizimit** në kundërshtim me Nenin 339 (1) në lidhje me (3) të KPK-së;

Në mënyrë të veçantë, sepse si person zyrtar, nëpërmjet të Letrës së Autorizimit të pranuar më 17 Mars 2005, të deleguar kështu zyrtarisht nga Zyra e Presidentit të Kosovës, ai e abuzoi pozitën e tij zyrtare dhe tejkaloi kufijtë e autorizimit të tij me qëllim të krijimit për vete, si dhe për kompaninë Auto Park Loningen, përfitim material të kundërligjshëm me dëmtimin përkatës të Zyrës së Presidentit të Kosovës, në kushtet e përshtuara nga aktakuza e ndryshuar;

Në bazë të Nenit 390, n.3 të KPPK-së,

Qeser Baholl

Në lidhje me aktet e njëjta penale të ngarkuara kundër Mujë Ukaj dhe Nexhat Shatri nuk shpallet fajtor dhe për këtë arsye është liruar.

Për arsyet e përmendura më sipër Trupi Gjykses lëshon në vijim këtë

DËNIM

1. Mujë Ukaj

Në përcputhje të Nenit 38 të Kodit Penal të Kosovës dhe Nenit 233 dhe Nenit 23, është dënuar me burgim prej 2 vjet dhe 2 muaj.

Në bazë të Nenit 41, paragrafi 1 pika 1, 42, 43 dhe 44 të KPPK-së, dënimi kundër **Mujë Ukaj** është me kusht. Dënimi nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri nuk e kryen një vepër tjetër penale për periudhën prej katër vitesh;

2. Nexhat Shatri

Në pajtim me Nenin 38 të Kodit Penal të Kosovës dhe Nenin 233 dhe Nenin 23, dënohet me 2 vjet e 2 muaj burgim.

Në pajtim me Nenin 41, paragrafi 1 pika 1, 42, 43 dhe 44 QKK, dënimi kundër **Nexhat Shatri** është me kusht. Dënimi nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri nuk e kryen një vepër tjetër penale për periudhën prej katër vitesh;

3. Blerim Svirca

Në pajtim me Nenin 38 të Kodit Penal të Kosovës dhe Nenin 339, dënohet me 3 vjet e 4 muaj burgim.

Në pajtim me Nenin 73 të KPPK-së koha e kaluar në paraburgim nga 1 Shtatori 2005 deri më 21 Janar 2006 do të llogariten në kuadër të dënimit.

Në pajtim me Nenin 277 (4) të KPPK-së lirimi me dorzani i caktuar ndaj Blerim Svirçës në vlerë për 60.000,00 EURO, në pajtim me vendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake Nural Khan të datës 20 Janar 2006, anulohet.

Në pajtim me Nenin 494 të KPPK të njëjtën sasi parash e EURO 60.000,00 është konfiskuar dhe është transferuar në thesarin e Kosovës.

SHPENZIMET

Në pajtim me Nenin 102 paragrafin 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) personat e dënuar do të paguajnë shpenzimet e procedurës të cilat janë të përcaktuara, në raport me numrin e seancave të mbajtura, në 400,00 euro.

ARSYETIMI

A. Sfondi procedural

Më 20 Korrik 2006, prokurori e UNMIK-ut Andrea Venegoni ka ngritur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë aktakuzën kundër katër të akuzuarve.

Një version i ndryshuar i aktakuzës, është parashtuar më 18 Korrik 2007. Në të, i vetmi ndryshim substancial ishte modifikimi i një shume në fagen 11 të dokumentit, nga 935,000.00 Euro në 750,000.00 Euro.

Seancën e konfirmimit u mbajt më 12 Shtator 2007.

Me vendimin e datës 14 Nëntor 2007, gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës i konfirmoi të gjitha akuzat ndaj të akuzuarve.

Rasti ishte nën juridiksionin e gjyqtarëve të EULEX-it, pas vendimit të Presidentit të gjyqtarëve të EULEX-it më datën 5 Janar 2009, në bazë të Neneve 3 dhe 16.2 të Ligjit 03/L-053 për kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, nëse "rasti penal mbetet nën autoritetin e gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë".

Gjykimi filloi më 7 Shtator 2010. Pas formaliteteve paraprake (duke përfshirë komunikimin e përbërjes të trupit gjykues, verifikimin e thirrjeve të dëshmitarëve të ditës, leximi i aktakuzës dhe deklartimet e të akuzuarve mbi fajësinë) shqyrtimi i dëshmitarëve filloi. Dëshmitarët Hashim Dëshishku, Bekim Canolli dhe Lumniqe Murati u dëgjuan në rriedhën e seancës.

Në seancat e pasuan, dëshmitarët janë dëgjuar në renditjen vijuese.

Më 8 Shtator 2010 dëshmitarët Mustaf Avdyli, Latif Islami, dhe Ganimete Bytyçi.

Më 17 Shtator 2010 dëshmitarët Elez Nikçi, Shyqrije Hakaj dhe Mentor Mulliqi.

Më 5 Tetor 2010, dëshmitarët Xhemajl Prekaj, Skender Komoni dhe Nazmi Berisha.

Më 7 Tetor 2010, trupi gjykues mori vendim mbi pranimin e provave dhe, bazuar në kërkesën e palëve, të cilët ankoheshin se nuk kishin marrë ende përkthimet e procesverbalit të seanceve të gjyqimit, e shtyu për shqyrtimin e të akuzuarit për 3 Nëntor 2010.

Më 3 Nëntor 2010 pasi shqyrtimi i të akuzuarve.

Gjykata dëgjoi fjalimet e përmbyllëse të Prokurorit Publik, të Avokatëve Mbrojtës dhe të të akuzuarve më 8 Nëntor 2010.

Përfundimisht, trupi gjykues shpalli aktgjykimin në seancën e radhës, të mbajtur më 26 Nëntor 2010.

B. Kompetenca e Gjykatës

Sipas Nenit 23 pika 1) i) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), Gjykata e Qarkut janë kompetente për të dëgjuar dhe gjykuar rastet penale që përfshijnë akuzat për të cilat ligji lejon caktimin e një dënimi penal të së paku pesë vjet. Në pajtim me Nenin 27, paragrafi (1) i KPPK-së, kompetenca territoriale është e dhuruar me Gjykatën në trehin ku krimi pretendohet se është kryer.

Tre të pandehurit (Muji Ukaj, Nexhat Shatri dhe Qefser Bahollj) janë të ngarkuar me veprën penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose të Autorizimit, në kundërshtim me Nenin 339 (1) dhe (3) të KPK-së, të gjithë si bashkë-autorë në pajtim me Nenin 23 të të njëjtit kod. Vepra penale në fjalë bart një dënim në maksimum tetë vjet, mjaft lart mbi pikën e kërkuar me ligji.

I pandehuri i fundit është akuzuar për pastim parash, në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2 Neni 10. Vepra penale është e dënueshme me burgim deri në dhjetë vjet.

Ngjarjet e përshkruara në akuzat pretendohet se kanë ndodhur në Prishtinë, ku pasojat e sjelljes së supozuar të paligjshme kanë ndodhë.

Bazuar në këtë mund të konkludohet se Gjykata e Qarkut të Prishtinës është organi kompetent gjyqësor për të dëgjuar këtë procedimin penal si për jurisdicionin materiale poashtu edhe atij territorial.

Në kohën e Mundësisë Vepruese Fillestare, kur misioni i EULEX-it filloi kompetencat e saja ekzekutive (9 Dhjetor 2008), rasti i është caktuar një paneli të EULEX-it, pas vendimit të Presidentit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, zjij. Giuliana Civimini, me zbatimin e Ligjit mbi Kompetencat.

Në hapje të gjyqit, përbërja e panelit është bërë e njohur të palëve. Nuk ka kundërshtim u ngrit kundër përbërjen e Panelit

C. Përmbledhja e Provave të Paragjitura

Gjatë rjedhës së shqyrtimit gjyqësor, dëshmitarët e mëposhtme janë dëgjuar:

Më 7 Shtator 2010

- (1) Hashim Deshishku
- (2) Bekim Canolli
- (3) Limnije Murati

Më 8 Shtator 2010

- (4) Mustaf Avdyli
- (5) Latif Islami
- (6) Ganimele Bytyqi

Më 17 Shtator 2010

- (7) Elez Nikqi
- (8) Shyqyrije Hakaj
- (9) Mentor Mulliqi

Name: *A Svrca final Judgment_EA*

Translated by: *IV 1- Phone: 4080*

17, VR 18-34

Page: 5 of 36

Më 5 Tetor 2010

- (10) Xhemajl Prekaj
- (11) Skender Komoni
- (12) Nazmi Berisha

Më 7 Tetor 2010, dokumentet në vijim janë konstatuar sit ë lexuara në procesverbal;

- (13) deklaratat e Michael Sawatzki
- (14) deklaratata e Fred Koroushi
- (15) deklaratat e Michael Hellbrueck
- (16) dokumentat e siguruara nga Zyra e Presidentit dhe Departamentit të Thesarit, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave (në dosje të ndryshme)
- (17) dokumentat bankare të llogarive bankare të Autopark Loeningen, Ital Kosova, Dëshishku dhe Bucaj.
- (18) dokumente nga të Ndihma Ndërkombëtare Ligjore nga të Gjermania Shtetet e Bashkuara
- (19) dëshni nga gjurmimet dhe kërkimet.

D. Vlerësimi i Proeve të Paraqitura

1. Dëshmia e Hashim Dëshishkut

Dëshmitari, një afarist Kosovar, ishte në kohën e fakteve dhe është ende sot drejtor i kompanisë Lesna; ishte aksionar dhe kryetar i bordit të drejtorëve. Ai e konfirmoi se, në marrëveshje me drejtorin e përgjithshëm dhe drejtorin financiar të bankës, është vendosur të aprovohet një kredi afat-shkurtër (dy-tre javë), në shumë prej 800.000,00 Euro për Blerim Svirçën (përmes llogarisë bankare të kompanisë së tij, Italkosova).

Ai e konfirmoi atë që e kishte thënë në deklaratën e dhënë tek hetuesit më 3 Shkurt 2006 pra, se Blerim Svirca pas martes së huasë deklaroi se paratë do të kërtheheshin nga ana e një prej ministrive të Kosovës.

Kërkesa për kredi, e kujton dëshmitari, ishte fillimisht vetën gojarisht, por pastaj pasoi kërkesa me shkrim. Z.Dëshishku e konfirmoi pikëpamjen pozitive të bankës për klientin ("fakti se ne ia huazuam 800.000,00 Euro tregon se ai konsiderohej si një klient shumë i mirë"¹). Dëshmitari e konfirmoi se atë kohë ai vetën e njihje Blerim Svirçën dhe se nuk e kishte takuar asnjërin nga të pandehurit e tjerë përpara gjyqimit.

Mr.Dëshishku konfirmoi se asgjë kolaterale e as garanci nuk kërkoi nga banka kur kredia është dhënë. Ai i justifikoi rrethanat e pazakontë duke deklaruar se "kur ne japim kredi afat-shkurtër, në rastet urgjente, kolateralja nuk kërkohet". Lidhur me pikën e formaliteteve të kërkuaara dhe që i pëmbahet banka, ai më tej shtoi: Në raste të jashtëzakonshme, ne nuk i pëmbaheshim këtij llojit të kontratës, por kishim një marrëveshje verbale se ai do të kërthente paratë brenda dy javësh ... Po, jo vetën unë por i

¹ I pandehuri I njëjti, Svirca, përkundrazi, ka mendim ndryshe: gjatë shqyrtimit të tij më 17 Shtator 2005, e pranon se Italkosova

"vetën mbijetonte. E mban biznesin. Për shak se ekziston konkurrence dhe neve nuk kishim sukses" (faqja 7 e deklaratës).

tërë bordi kishte (shumë besim në të). Dhe paratë këtheheshin". Dëshmitari refuzoi të pranojë anomalinë e veprimin të pazakontë të lejuar nga banka dhe këmbënguli, dhe kontestoi vazhdimisht se kredia, në rrethana të caktuara, ishte një praktikë normale.

2. *Dëshmia e Bekim Canolli*

Një asistent administrativ në Zyrën e Presidentit të Kosovës (ZPK) si zyrtar i logjistikës dhe receptionist, pak më parë fakteve të përshkruara në aktakuzë ai ishte emëruar nga zyrtari i lartë civil, Mujë Ukaj, si zyrtar alternativë i ertififikimit në vërteton në ZPK, i ftuar të zëvendësojë Ganimete Bytyçi në rast të mungesës së saj. Dëshmitari e pranoi që nuk ka kualifikime të nevojshme profesionale si zyrtar alternativ i ertififikimit, duke e konfirmuar se emërimi i tij ishte vetëm një formalitet. Atij i kujtohet nënshkrimin e dhënë në një urdhër detyruës për blerjen e automjeteve të blinduara për ZPK dhe shkurtimisht i rrefeu rrethanat dhe modalitetet e procedurës administrative. Ai e përmendi se u ftua për të nënshkruar një dokument të hartuar paraparakisht në zyrën e Sekretarit, Mujë Ukaj. Atij i kujtohet hezitimi i tij për të nënshkruar për shkak të urgjencës që është imponuar mbi të, shuma përkatëse e autorizimit, kompleksiteti i procedurës, të cilë nuk e kuptonte dhe ishte e pazakontë për të; por ai tha se në fund e nënshkroi, duke iu bindur urdhrit të dhënë atij nga i pandehuri, Mujë Ukaj. Pas freskimit të kujtesës së dëshmitarit, z. Canolli e konfirmoi se ka deklaruar në Prokurori se ishte një urdhër dhe atë i treptë ... Nuk është se ata më detyruan, ishte një lloj presioni sepse ishte nga përfundimi i orarit të punës dhe ata thanë: Askush nuk do të largohet nga kjo zyrë pa e nënshkruar këtë dokument".

Ai e konfirmoi se u takua me Blerim Svirçën një herë në zyrën e Sekretarit dhe kanë pirë kafe me të, pak kohë pas nënshkrimit. Megjë punonte në ZPK, ai padyshim i njihje të pandehurit e tjerë.

3. *Dëshmia e Lumnije Muratii*

Në Janar 2005, dëshmitari u emërua si zyrtare e miratimit nga sekretari i përhershëm, Mujë Ukaj, pavarësisht mungesës së përvojës së saj në këtë fushë.

Dëshmia e saj në tërësi u përgendrua në rrethanat e nënshkrimit të urdhrit të pagesës detyruese të kërkuar prej saj për shumën një milion euro. Dëshmitarja pa nguruar përmendi momentet e vështira që i përjetoi për shkak të presionit të ushtruar mbi të nga Mujë Ukaj, në mënyrë që të ketë nënshkruajë CPO-së (Urdhër për Pagesë Detyruese). Në kundërshtimin e dëshmitarit për të nënshkruar shumën e urdherit, mungesa e dokumentacionit mbështetës dhe koha e shkurtër që i lejohet asaj për shqyrtimin e çështjes, në fund të orarit të punës, përgjigjia e Sekretarit dhe e Nexhat Shatrit ishte një përzjerje e arrogancës dhe e bindshmërisë. Dëshmitari e njohu nënshkrimin e saj, duke vënë re se duart e saj dridheshin në çastin kur dha nënshkrimin. Lumnije Murati vazhdoi të tregojë se ajo nënshkroi edhe një urdhër të dytë për blerjen e njëjtë, që përmbante shumën prej 400.000,00 e më shumë euro.

Dëshmitarja më tej pohoi se ajo kishte kontakte të rregullta me asistenten personale të Presidentit Rugova, Lumturije Shabani, e cili me një rast i tha asaj, "Pse nuk e nënshkruan këtë? Pse nguron për të nënshkruar këtë dokument?".

4. *Dëshmia e Ganimete Bytyçit*

Si zyrtare e certifikimit në ZPK, në kohën e fakteve, ajo mori pjesë në procedurën për blerjen e makinave të blinduara, përgatitjen e CPO-së 7561 me të dhënat përkatëse, me urdhër të Mujë Ukaj.

Duke iu përgjigjur pyetjeve të palëve, dëshmitarja e përshtroi në tërësi detyrën e saj si zyrtare të certifikimit në përgjithësi dhe në rasin konkret.

Me kërkese të kryetarit të trupit gjykues, dëshmitarja e konfirmoi shumën e pazakontë të shënuar në CPO që ajo duhej përgatitur, në krahasim me përvojën e saj të mëparshme ("në bazë të përvojës sime dhe unë kam punuar aty që nga viti 2003, kurrë nuk ka ndodhur që të lëshohet madje edhe për shumën prej 500.000 euro") dhe në shqyrtimin e buxheut vjetor të ZPK ("2 milionë e gjysmë").

Dëshmitarja vuri në dukje anomalinë e procedurës, pasi që asaj nuk i është dhënë asnjë mundësi të verifikojë të dhënat dhe dokumentet në lidhje me veprimin që kërkohet nga ajo të kryejë. Asaj madje i ndalohej, në kundërshtim me praktikën ekzistuese në zyrë, të mbajë një kopje të dokumentit dhe ishte paralajmëruar që të trajtojë këtë çështje si konfidenciale dhe mos t'ia zbulojë dokumentin askujt.

5. Dëshmia e Latif Islami

Latif Islami ishte Drejtor i Departamentit për Kredi në Kasabank në 2005. Dëshmitari e përmendi se Blerim Svirca ishte një klient i shkëlqyer i bankës, "i rregullt me pagesat ... i qëndrueshëm në karakter dhe me një personalitet të shkëlqyer". Në lidhje me çështjen e kredisë së 800.000,00 euro, dëshmitari shprehur mendimin e tij se kjo ishte më tepër një huamartje ose një overdraft në llogarinë bankare të kompanisë Italkosova se sa një hua formale, pasi që asnjë shkresë nuk është bërë kur janë dhënë të hollat dhe departamenti i tij nuk kishte lidhje për procedurën në tërësi. Dëshmitari i pyetur në lidhje me rregullsinë e procedurës (pa ndonjë dokumentacio të kredisë), i është përgjigjur në mënyrë bishmtuese dhe është përpjekur të justifikojë veprimtarinë e bankës. Afër përfundimit të zhqyrtimit të tij, ai u ballafaqua me deklaratën që ia kishte dhënë policisë më 23 Janar 2006, ku ai kishte deklaruar se "Blerim Svirca, si klient i Casa Bank-ës, është klient i keq, i cili ka qenë i paditur në Gjykatë për mos përmbyshjen e detyrimeve ndaj bankës, ai përdori paratë e siguruarra nga banka që nganjëherë më vonë paratë i kërtheshin Kasabank-ës, këto para nuk lejoheshin nga departamenti i kredisë ". Dëshmitari ka konfirmuar se nuk i njeh Mujë Ukaj dhe Nexhat Shatri.

6. Dëshmia e Mystaf Avdylli

Një zyrtar i bankës, ai e përshtroi procedurën për huamartjen prej 800.000,00 euro, duke konfirmuar se Komiteti i Kredisë së bankës ka qenë i përfshirë dhe e ka autorizuar kredinë. Dëshmitari e ka përmendur Hashim Deshishkun, Millazim Abazin dhe Millazim Zeqinin si anëtarët të Komitetit të Kredisë që e autorizoi veprimin, por përmendi se një dokument me shkrim i një seance ose të një shqyrtimi të Komitetit në fjalë kurrë nuk i është dhënë atij. Avdyli shprehu mendimin e tij se kredia ishte bërë në mënyrë të rregullt duke shtuar se megjithatë: "Në goftë se një komision vendosi, anëtarët e të cilit janë aksioner kryesore dhe të dorës së dytë dhe drejtori i bankës në atë rast, ajo miratohet ... Praktika është që klienti do të vijë në bankë, aplikon dhe do dorëzon dokumentacionin.

Komisioni i bankës shkron në teren për të vlerësuar dhe për të çmuar klientin dhe pastaj të jap vlerësimin dhe në bazë të vlerësimit pozitiv kërkesa i paraqitet komisionit për aprovim dhe pastaj komisioni vendos nëse duhet të miratohet".

7. Dëshmia e Elez Nikqit

Elez Nikqi nga 1999 deri më 2005/2006 ishte kreu i sigurisë së Presidentit të ndjerë Rugova. Ai tha se ishte përfundimi i tij se arsyeja për zëvendësimin e tij në atë pozicion ka qenë "gëshnja e automjetit të blinduar që dilte në sipërfaqe". Ai shtoi se: "ata e dinin se po të kisha qenë unë aty, atëherë këto automjete nuk mund të blisheshin në mënyrën si jamë blerë ato dhe ata e bënë këtë lojë për të mbajtur larg meje blerjen e automjeteve".

Dëshmia e dëshmitarit ishte në përgjithësi me një ton kundërsulmues, duke u bazuar se dëshmitari ishte i hindur se karriera e tij kishte qenë i paragjykuar.

Ai e konfirmoi se njihje Ramë Maraj dhe Blerim Svirca një kohë të gjatë.

Me kërkesë të mbrojtësit, dëshmitari përshkroi me bollëk të dhënat e blerjes së një makine të blinduar, kur ai ishte shef i sigurimit të Rugovës.

8. Dëshmia e Shyqirje Hakaj

Shyqirje Hakaj është shefe e Buxhettit dhe Financa në ZPK, pozitië të cilën e ka pas që nga viti 2003. Ajo tha se ka nënshkruar CPO-në për pagesën e automjeteve të përshkruara në aktakuze. Megjithatë, ajo shpjegoi, se atë kohë ajo "u sëmure nga fshkeza e tëmthit" dhe "Nuk isha në pushim mjekësor, por më dubej me marrë ilace kohë pas kohë. Ky nënshkrimi im mund të jetë dhënë nga kush do qoftë". Me fjalë të saja, dokumenti ishte sjellë tek ajo në banesën e saj për ta nënshkruar duke thënë se ishte urgjente" dhe e kam nënshkruar atë". Pas fteskimit të kujtesës së dëshmitares, dëshmitarja e konfirmoi se e ka nënshkruar një dokument blanko, e cila nuk kishte dokumentacionin e nevojshëm të bashkangjitur.

9. Dëshmia e Mentor Mulliqit

Mentor Mulliqi në 2005 ishte punonte në Pejë, si doganier. Në cilësinë e përmendur ai procesoi dokumentet në lidhje me automjetet e blinduara të importuara për përdorim të ZPK. Detyra e tij ishte që të shih dhe të ekzaminojë mallrat, në rastin konkret, detajet teknike, numrin e shasisë, ngjyrën, numrin i ulseve, kapacitetin e motorit. Atij i kujtohet se në gashin kur dokumentacioni është pranuar, u konstatua se automjetet nuk ishin në gjendje që ata ishin dashur të jenë. Zyrtarëve në fjalë iu është thënë "për të rregulluar të gjithë dokumentacionin përkatës në lidhje me automjetet dhe se makinat duhesh sjellur herën tjetër". Dëshmitari në Gjykatë e përmendi se ai e kishte shprehur hutinë e tij tek eprori i tij, i cilin e ftoi atë të vazhdojë gjithsesi, pas një konsultimi me sejinë e doganës në Prishtinë.

10. Dëshmia e Nazmi Berishës

Nazmi Berisha, një zyrtar i doganës nga Tetori 2002 deri në Janar 2010, nuk kishte

njohuri të drejtpërdrejtë të fakteve të përshkruara në aktakuzë. Kur hetimet e rasit filluan, në vitin 2005, nga ai ishte kërkuar të bashkëpunojë me policinë e UNMIK-ut.

11. Dëshmia e Xhemajl Prekajit

Xhemajl Prekaj ishte një udhëheqës i ndëritimit në shërbimin e doganës në Pejë në vitin 2005. Ai e konfirmoi versionin e vartësit të tij në lidhje me ardhjen e dokumenteve të automjeteve dhe të automjeteve në aeroportin e Gjakovës. Ai e konfirmoi çfarë u tha nga Mulliqi, se pas konsultimit me Shtabin në Prishtinë, u vendos të spastrohet procedura për importimin e makinave, duke pasur parasysh destinacionin e tyre përfundimtar dhe shkallën e ulët ose jo ekzistues afre të rezikut që i gjithë operacioni të rezultojë në dëm të Doganës së Kosovës. Siç e përmendi dëshmitari, katër makina janë prezantuar fizikisht për ekzaminim, ndërsa dy të tjera mungonin. Përveç kësaj, pagesa për tatum të importit ishte bërë për gjashtë makina. Ashtu siç e konfirmoi dëshmitari, nuk kishte bishtrim të taksave doganore dhe pagesa është bërë si për deklaratë doganore.

11. Dëshmia e Skënder Komonit

Një zyrtar tjetër i doganës, i përfshira në procesin e 'harmonizimit' të dokumentacionit të importimit të automjeteve për Zyrën e Presidentit të Kosovës, ai e ka përmend, në kupumin e përgjithshëm, procedurën. Dëshmia e tij në tërësi ishte e një rëndësie të vogël.

Vlerësimi i provave

Në përgjithësi, marrja në pyetje e dëshmitarëve ishte e butë dhe e qetë.

Në disa raste, dhe vetëm nga ana e një të pandehuri (Mujë Ukaj) shqyrtimi i dëshmitarit ka prezantuar elemente kontraverze. Përveç kësaj, kontestimet e shytyra nga i pandehuri Mujë Ukaj personalisht nuk janë bazuar në fakte të veçanta, por në zhvlerësim të përgjithshëm të besueshmërisë së disa dëshmitarëve (Canolli, Murati) duke u bazuar në cilësinë e tyre si dëshmitarë bashkëpunues.

Nga ana tjetër, Prokurori (dhe, herë pas here, kryetari i trupit gjykues) vetëm sporadikisht i janë çasur mekanizmit të parashikuar nga Neni 364 KPPK, në mënyrë që të freskojë kujtesën e dëshmitarit.

Dëshmitarët mund të grupohen në tri grupe.

Grupi i parë është i formuar nga ana e punonjësve të bankës dhe nga Hasim Deshishku, aksionar dhe kryetar i bordit të drejtorëve të Kasabank-ës. Këta dëshmitarë kanë shpjeguar mbi modalitetet e koncesionit të kreditës së dhënë kompanisë Italkosova, e cila ishte një klient i bankës. Deklaratat e tyre në Gjykatë në mënyrë epizodike janë larguar nga ato të dhëna hetuesve, por me pasoja të kufizuara.

Për shembull, dëshmia e Latif Islami. Dëshmitari e përshkroi (dhe e përsëriti, pavarësisht nga Neni 364 që Prokurori ia kontestoi atij versionin ndryshe të dhënë tek hetuesit), Blerim Svirca, si një klient të mirë të bankës dhe një biznesmen të vlefshme: Megjithatë, Islami e kishte përshkruar gjendjen ekonomike të të pandehurit në kuprim negativ në

Name: A Svirca final Judgment_EA

Translated by: IV 1- Phone: 4080

17, VR 18-34

Page: 10 of 36

deponimin e tij në hetuesi; përveç kësaj, raportet bankare të llogarive që gjenden në dosjen e konfirmojnë se llogaria bankare e Italkosova atë kohë ishte përherë në të kuqe.

Mystaf Avdyli pjesërisht u largua prej deklaratës së tij të mëparshme të dhënë hetuesit, të paktën në pjesën ku ai i komenton modalitetet e kredisë në kushtet normale.

Nuk kërkohet një shkallë e madhe e sofistikimit ose përvojës në gëshjtet ekonomike për të kuptuar se versioni i fundit i dhënë nga dëshmitari është i pabazë dhe i bazuar vetëm në favor të përgjithshëm ndaj klientit apo dëshitës për të shmangur diskreditimin e bankës, e cila aq lehtë ka lejuar veprimin kreditor në rrethana në dukje të dyshimta. Mendja e shmosh na mëson se vetëm ekzistimi i një lidhjeje personale midis Blerim Svirçës dhe kryetarit të bordit të drejtorëve të bankës (Mr.Deshishku) dhe afërsia e Svirçës me Presidentin e Republikës së Kosovës e ka lejuar marrjen e kredisë 800,000,00 përkundër mungesës së garancive brenda dy ditësh dhe pa asnjë dokument me shkrim.

Pavarësisht mospëputhjeve të tilla, dëshmitë e tre dëshmitarëve që i përkasin këtij grupi (Latif Islami, Mystaf Avdyli, Hashim Deshishku) kanë kontribuar në sqarimin e fakteve të gëshlyes. Rrethanat e përmendura nga ana e tyre në mënyrë adekuate ilustrojnë rolin e Blerim Svirçës në këtë rast, roli i të cilit, siç do të shpjegohet më mirë më vonë, nuk mundet thjesht të reduktohet në rol të vogël të një ekzekutuesi të urdhërave të eprorit ose të shoferit të makinës nga aeroporti i Gjakova.

Grupi i dytë i dëshmitarëve përfshin punonjësit e ZPK. Këta individë, të gjithë vartësit e të pandehurve Mujë Ukaj dhe Nexhat Shatri, janë Bekim Canolli, Lumnje Murati, Ganimete Bytyçi, Shyqirije Hakaj.

Çështje e deponimit të tyre në Gjykatë ishin rrethanat dhe modalitetet përmes së cilave procedura për blerjen e automjeteve për ZPK është kryer. Dëshmitarët e përshtkruan në kuptim të përputhshëm anomali të procedurës, për sasinë e parave të përfshira, për shpejtësinë dhe për mungesën e konsiderueshme të kontrollit të tërë operacionit. Nën drejtimin e Nexhat Shatrit dhe Mujë Ukajt, ata ishin vënë në gjendje (i janë nënshtruar presionit të tepërt) për të nënshkruar pa pasë mundësinë praktike të shqyrtojnë dokumentet që i paraprinë blerjes dhe për këtë të verifikojnë se çfarë ishin duke bërë.

Dëshmitë e këtij grupi të dëshmitarëve vërtetojnë reciprokisht përshtkrimin e fakteve. Deponimet e tyre janë tregime të thjeshta të fakteve logjike dhe të detajuar. Përkundër përplekjeve të z.Mujë Ukajt për të diskredituar dy prej tyre (Canolli dhe Murati), duke u bazuar në cilësinë e tyre si dëshmitarë bashkëpunues, deklaratat e tyre ishin të besueshme. Jo vetëm se ata konfirmuan në çdo fragment atë që ata i thanë hetuesve menjëherë pas fakteve (dhe para se të shpallen dëshmitarë bashkëpunues në ndërkohë); ajo që ka rëndësi më shumë është se ata dhanë përshtkrime të sakta dhe shpjegime logjike për pjesën e tyre të veprimit në procedurë. Në çdo kohë, ata u përpogën të bëjnë dallimin e përgjegjësive së tyre administrative nga përgjegjësia e atyre që e kishin inicuar procedurën dhe e imponuan mbi ata (dëshmitarët), një procedurë në lidhje me të cilën të dëshmitarët kishin huti të fortë.

Nga shpjegimet e dhëna të dëshmitarëve, doli në mënyrë të qartë se që të katërt (Bekim Canolli, Lumnje Murati, Ganimete Bytyçi, Shyqirije Hakaj) thjesht kryen (pavarësisht hutisë) urdhërat që kanë marrë për zhvillimin e procedurës, duke nënshkruar CPO-në. Dhe kjo nuk mund të ishte ndryshe, meqë e tërë procedura është duke u zhvilluar, për

shkak të rëndësisë dhe fshetësisë së saj të jashtëzakonshme, nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Krye-sekretarit dhe Shefit të Prokurimit të ZPK. Tingjellon me të vërtetë si zemërgushtësi dhe jo inkurajuese përpjekja e bërë në kohë të caktuar nga Mujë Ukaj të ngarkojë vartësit me përgjegjësi për procedurën. Një çasje që është e destinuar të dështojë, në çdo rast, pasi që ishte e qartë për trupin gjykuës gjatë gjithë deponimit të katër dëshmiarëve, se Bekim Canolli, Lumnje Murati, Ganimete Bytyçi, Shyqirije Hakaj ishin në rolet e tyre përkatesë të vërtetë dhe ekzekutues besnik të urdhërave që vijnë nga lart pra, nga Mujë Ukaj dhe Nexhat Shatri.

Në këtë grup, dëshmitari Elez Nikçi mund të shohet, në qoftë se edhe deklaratat e tij të përgjendrohet më tepër në vështrësitë e tija personale profesionale se sa në procedurën e blesjes së automjeteve. Për këtë arsye, dëshmia e tij mund të konsiderohet e rëndësishë së dorës së dytë.

Grupi i fundit i dëshmiarëve përfshin zyrtarët e doganës, Mentor Mulliqi, Xhemajl Prekaj dhe Skender Komoni, të cilët në cilësinë e tyre përkatesë, kanë genë të përfshirë në procedurën e shqyrtimit të automjeteve, të harmonizimit të dokumentacionit dhe të përcaktimit të tarifave të importimit dhe pagesës.

Deponimet e tyre nuk ishin në thelb kontraste. Ata ndihmuan për të hedhur dritë mbi faktet e rasisit, duke konfirmuar pagesën e taksave të importit dhe, kryesorja, konfirmuan se e tëtë procedura e blesjes (duke përfshirë edhe harmonizimin e dokumentacionit dhe pagesës së tatimit të importimit) u trajtua jashtë praktikës normale, pasi që mallrat ishin për përdorim nga ana e ZPK-së.

Dëshmitari Nazmi Berisha mund të përfshihet në grupin e tretë, edhe pse për arsyet e shpjeguara më lart, deponimi i tij është i rëndësishë së pëarfërt në konstatimin e fakteve të çështjes.

Nga provat e mbledhura gjatë rrjedhës së gjykimit dhe të pranuar nga Paneli, rindërtimi i fakteve mund të nxirret si në vijim.

Pas një sulmi me eksploziv kundër makinave të blinduara të presidentit të Kosovës, z. Rugova, me ç'rast makina u dëmtua dhe ka trezikuar jetën e shefit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, u vendos blesja e një numër të automjeteve të blinduara dhe të pa-blinduara me urgjencë për ZPK.

Nga deklaratimet e të pandehurve të njëjtë doji se vendimi është marrë në nivelin më të lartë të institucionit, mu nga vet Presidenti Rugova, në zbatim të kështillave që i është dhënë nga kreu i sigurisë presidenciale.

Rrethana gjen një konfirmim të arsyeshem në deklaratën e dëshmitarit Lumnje Murati, e cila kujtoi kërkesën e asistentes personal të Presidentit Rugova, Lumturije Shabani, me të cilin ajo ka kontakte të përditshme, i cili e pyeti me një rast lidhur me arsyet pse ajo hezitonte të nënshtkuaj CPO-në. Nga kjo kuptohet se Presidenti Rugova, përmes asistentes së tij personale ishte informuar për procedurën, ekzistencën (dhe shumën) e

CPO-së dhe praninë e hezitimit nga të paktën një anëtar të personelit lidhur me procedurën e veçantë. Duhet të konkludohet se vet Presidenti Rugova, siç pretendon i pandehuri Mujë Ukaj, ka marrë vendim për të blerë numrin e caktuar të makinave që kanë genë mall i blerjes.

Duke iu përgjigjur pyetjes së gjyqtarit kryesues, të pandehurit e njëjtë kanë konfirmuar se vendimi i Presidentit nuk ishte i kufizuar në treguesin e numrit të makinave për të blerë. Edhe emrin i shitësit (të makinave – v.j) jashtë vendit që të kontaktohet lidhur me blerjen e automjeteve është caktuar nga z. Rugova në mënyrë të pavarur, pra pa ndonjë konsultim me zyrën e prokurimit. Për më tepër, doli se Presidenti Rugova kishte pasur kontakt të drejtpërdrejtë telefonic me shitësin e makinave, z. Nikçi, aksioneri kryesor i kompanisë Autoloningen & Autoloningen, të cilin i kishte treguar për nevojat e zyrës së tij.

Në këtë rindërtim të fakteve, nuk ka prova të drejtpërdrejta, meqë as gjatë fazës së hetimeve e as gjatë fazës së gjyqimit, Prokurori nuk është përpiqur të kuptojë se kush ka qenë iniciator i gjithë procedurës. I kënaqur me idenë se zgjedhja e automjeteve dhe e shitësit është bërë nga ata të cilët pretendohet se i kanë abuzuar funksionet, ky aspekt nuk është hetuar me të vërtetë.

Megjithatë, rrethana është konfirmuar edhe nga disa fakte të tjera. Në radhë të parë, rrethana se në ZPK, të drejtuar nga sekretari Mujë Ukaj, dhe në zyrën e prokurimit, të drejtuar nga Nexhat Shatri, nuk ka pasur ndonjë aktivitet të drejtuar në përzgjedhjen e një shitësi. Kjo pikë do të duhet të shqyrtohet në një fazë të mëvonshme, për shkak të rolit që luan në aspektin e kualifikimit juridik të fakteve. Që tani, megjithatë, rëndësia e saj qëndron në përshatshmërinë e saj për të përfaqësuar një element të konfirmimit të versionit të Mujë Ukaj, se hulumtimi (nëse ka) dhe zgjedhja e shitësit dhe e makinave është bërë nga vetë Presidenti. Një konfirmim më tej se vendimi për të blerë automjete dhe zgjedhja e shitësit është bërë nga zyra e Sekretarit të Mujë Ukaj ose të zyrës së prokurimit të drejtuar nga Nexhat Shatri, është në kohën e operimit.

Bazuar në afatin kohor të ngjarjeve të përfaqësuar në provën 3 të bashkangjitur në deklaratën e dhënë më 7 dhe 13 Mars 2006 nga dëshmitari Michael Hellbrueck me rastin e dëgjimit të mundësise të jashtëzakonshme hetimore, mund të konkludohet se blerja e makinave i parapriu fillimit të procedurës administrative për prokurimin e mjeteve nga ana e ZPK-së.

Në shkresat e ndryshme, mund të gjenden prova që konfirmojnë këtë aspekt.

Ajo prezantohet nga dokumentacioni i përgatitur për blerjen e makinave dhe konkretisht:

- 1) Autorizimi i nënshkruar nga Qefser Baholli të datës 17 Mars 2005;
- 2) 2) Deklaratë nga marrësi i fundit dhe blerësi (kërkesë për eksportin e 6 makinave të blinduara) të datës 23 Mars 2005;
- 3) Raporti bankar i llogarisë bankare të kompanisë Italkosova, ku transferimi i parave në favor të Autoloningen është e dokumentuar dhe ku figuron data.

Të gjitha këto elemente faktike konfirmojnë se blerja e automjeteve u zhvillua para 24 Mars 2005, dmth para se të fillojë e gjithë procedura e prokurimit.

Burimi kryesor i informatave për blerjen prezantohet me deklaratat e dhëna nga Michael Hellbrueck. Dëshmitari, një hetues i UNMIK-ut, ka bërë një rindërtim të plotë të fakteve, në bazë të informacionit që ai kishte mbledhur dhe analizuar gjatë rrjedhës së hetimeve. Deponimi i tij është pranuar si dëshmi në gjykatë dhe mund të përdoret pa kufizim, pasi që avokatët mbrojtës të të akuzuarve (dhe të atyre të dyshuarve që kanë qenë në vonë deklaruar dëshmitar bashkëpunues) ishin të pranishëm gjatë marrjes në pyetje.

Në pikën e besueshmërisë së dëshmitarit, nuk spekulime mund të ngrihen spekulime: për shkak të pozicës së tij profesionale, dëshmitarit nuk ka lidhje me ngjarjet e përshkruara në akuzat dhe për interesat që ka shkaktuar atyre. Nëse jo në një pozitë të pavarur, duke vepruar nën drejtimin e Prokurorit, ai ishte një vëzhgues i shkëputur dhe analizues i fakteve të çështjes. Për këto arsye, argumenti i përdorur nga ana e Avokatit Mbrojtës në fillim të shqyrtimit të dëshmitarit se zyrtari i policisë, i cili ka vepruar si një hetues në një rast nuk mund të thirret për të dhënë dëshmi për objektin e hetimit të thënë, nuk është me vend (dhe kështu është cilësuar nga gjykatësi Boollell) dhe është i paligjshme.

Në rrjedhën e hetimit, Hellbrueck kishte hulumtuar, grumbulluar dhe shqyrtuar të gjithë dokumentacionin në dispozicion të çështjes; para gjykatësit Boollell, ai bëri një rikonstruksion të plotë të fakteve, që lidh me një lexim të plotë fragmentet e ndryshme.

Pasi përmendi pikën e fillimit të hetimit (pohimet për keqmenaxhim të fondeve në ZPK në shtyp), ai vazhdoi duke përmendur mbledhjen e dokumenteve për blerjen e automjeteve për ZPK nga zyra të ndryshme (të vetë ZPK-së, Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe Agjencinë e Prokurimit Publik të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Doganës së UNMIK-ut) dhe të përshkruara me fjalët e mëposhtme të të dyshuarit që menjëherë i dha një kalje hetimeve: "Në bazë të këtyre dokumenteve, çmimi i një makine të blinduar ishte 338.875 Euro. Kam gjeturuar në internet çmimin e automjetit të blinduar të përshkruar në detaje në faturë. Çmimi i blerjes për një automjet të ngjashëm ishte 130.000 USD për automjet ... Natyrisht, ZPK pagoi të paktën tri herë më shumë ... Pastaj lindi dyshimi se një vepër penale është kryer. Arsyeja për procedurat e prokurimit në ligjin e prokurimit publik është vetëm për të shmangur ose për të parandaluar shenzimin e kotë të kështillë të hollave".

Informacione të mëtejshme në lidhje me rastin dhe hetimit që pasoi është furnizuar nga dëshmitari në vazhdimin e deklaratës së dhënë më 13 Mars 2006.

Duke iu përgjigjur pyetjeve të prokurorit, Hellbrueck përshkroi zinxhirin e transfertave të parave dhe tërheqjen e parave që u zhvillua në gjysmën e dytë të Marsit 2005 në mes të llogarive bankare të Italkosova (në pronësi të pjesërishtme të Blerim Svirçës në atë kohë, i cili vepronte në cilësi të menaxhuesit), Loeningen Auto Park, Armouring Alpine Inc (Kompani amerikane, e cila ishte furnizuese origjinale e makinave), dhe të ZPK-së.

Përveç rrëfimit të dëshmitarit, lëvizjet e parave janë rikonstruktuar në mënyrë të qartë si në provën numër 1 (një grafik i rrjedhës i bashkangjitur në deklaratën e dëshmitarit) dhe në listën e transferimit të parave që përmbahet në Memorandumin e datës 21 Maj 2005, të shkruar nga dëshmitari i njëjtë.

Le të përmbledhim ato shkurtimisht:

23 Mars 2005

Italkosova, llogari bankare në Kasabanka
↓ 800.000,00 euro
Auto Park Loeningen, llogari bankare në Gjermani

29 Mars 2005

Auto Park Loeningen, llogari bankare në Gjermani
↓ 324.924,80 euro dhe 315.181,75 euro
Alpine Armouring inc., llogari bankare në SHBA

31 Mars 2005

Zyra e Presidentit të Kosovës, CPO 7561
↓ 1.016.625,00 euro
Auto Park Loeningen, llogari bankare në Kasabanka

31 Mars 2005

Auto Park Loeningen, llogari bankare në Kasabanka
↓ 800.000,00 euro dhe 210.000,00 euro
Italkosova, llogari bankare në Kasabanka

2, 4, 5, 6 dhe 21 Prill 2005

Pesë tërheqjet në cash nga Blerim Svirca nga llogaria bankare të Italkosova në Kasabanka në shumën totale prej 264.900,00 euro.

5 Prill 2005

Zyra e Presidentit të Kosovës, CPO 7561 dhe 5874
↓ 42.224,76 euro dhe 430.650,00 euro
Auto Park Loeningen, llogari bankare në Kasabanka

21/22 Prill 2005

Auto Park Loeningen, llogari bankare në Kasabanka
↓ 100.000,00 euro dhe 30.000,00 euro
Italkosova, llogari bankare në Kasabanka

21/22 Prill 2005

Auto Park Loeningen, llogari bankare në Kasabanka
↓ 100.000,00 euro dhe 75.000,00 euro
Auto Park Loeningen, llogari bankare në Gjermani

Përveç transfertave të parave, të raportuara më lart, në Memorandumin e përmendur të datës 21 Maj 2006, Hellbrueck përkthuan lëvizjet e tjera të dyshimta ose tërheqjen e parave nga e njëjta dhe nga llogaritë e tjera bankare të njëjten ditë dhe nga individë të njëjtë.

Këto transaksione nuk janë raportuar këtu në mënyrë analitike, për hirë të lehtësisë së leximit. Mjafton të thuhet se ato përbëhen nga një kalim i parave nga llogaria bankare e Auto Loeningen në Kasabanka më 22 Prill 2005 në favor të Hashim Dëshishkut (aksionar i bankës dhe dëshmitar në këtë gjyq), e cila pothuajse e balanson një transferim të parave në drejtim të kundërt të kryer më 14.04.2005 nga Dëshishku në favor të një llogari bankare të Auto Loeningen në Gjermani.

Rrethana të tjera që janë përmendur në Memorandum lidhet me (i) data e hapjes së llogarisë bankare në Kasabanka nga Auto Loeningen (30 Mars 2005, një ditë para pagesës së parë të CPO-së) dhe (ii) mënyra e transfertave të parave të kryera më 31 Mars nga Auto Park Loeningen për në llogarinë bankare të Italkosova në Kasabanka (shuma e përgjithshme e përmendur më lart, 1.010.000,00 euro. Lidhur me këtë pikë të fundit, Mustafa Avdyli, i ka deklaruar hebesit se nuk ekzistojnë dëftesa të transferit të parave dhe transaksioneve për shkak se ajo ishte urdhëruar drejtpërdrejtë nga Blerim Svirca. Edhe po mos të ishte autorizuar për të vepruar në llogarinë bankare të Auto Park Loeningen, operacioni është ekzekutuar gjithsesi duke marr parasysht marrëdhëniet e Berim Svirçës me menaxhmentin e bankës. Sidoqoftë, në lidhje me dy transaksionet në favor të Italkosova, asnjëherë nuk ka pasur ndonjë kundërpadi nga Xhevdet Nikçi apo Ahmet Ademaj, të dy përfaqësues ligjor të kompanisë Auto Park Loeningen, të cilët ishin të vetmit individ që kishin drejtën zyrtare për të menaxhuar llogarinë .

Lista e lëvizjeve të ndryshme të parave është me siguri komplekse dhe mund të jetë jo menjëherë e kuptueshme. Megjithatë, duke shikuar në një tablo të madhe, del se Italkosova e Blerim Svirçës, në sajë të marrëdhënieve personale të Svirçës me Hashim Dëshishkun dhe përbrenda Kasabankës, ishte në gjendje të merr fondet (800.000,00 euro) që u transferuan në Auto Park Loeningen të Gjermanisë për blerjen e **gjashtë automjeteve të blinduara** nga furnizuesi Amerikan (Alpine Armouring Ltd.). I gjithë operacioni, siç u tha edhe më parë, ka përfunduar para fillimit të procedurës në ZPK.

Posa ZPK-ja e pagoi Auto Park Loeningen-in, CPO-të 7561 dhe 5874 (në shumë të përgjithshme prej 1.489.499,76 Euro), në lidhje me blerjen e **katër makinave të blinduara dhe dy Hummerave**, Auto Park Loeningen ia këtheu Italkosovës së Blerim Svirçës 800.000,00 Euro për kredinë dhe më tej 210.000,00 më 31 Mars 2005 plus 100.000,00 si dhe 30.000,00 më 21 dhe 22 Prill. Nuk është dhënë justifikimi për shumën e 340.000,00 që tejkalon kthimin e kredisë. Nga kjo shumë, Blerim Svirca tërhoqi një pjesë të madhe në ditët në vijim, përmes një sërë tërheqjesh të parave.

Siç është përshtkruar nga dëshmitari Hellbrueck, operacionet e bankës janë të shënuara në vecanti, jashtëzakonshmeri dhe pakuptueshmeri.

Blerim Svirca është njeriu kryesor prapa tyre, personi i cili i bën të gjitha të mundshme. Pa pasë lidhjen e tij në sistemin e bankës dhe kapacitetin e tij për të garantuar se kredia prej 800.000,00 do të kthehej brenda pak ditësh, i gjithë operacioni nuk do të kishte ndodhur, ose të paktën jo në formën që ndodhi. Për pozitën e tij të të njohurit ('fjala 'mik' e përdorur nga disa prej dëshmitarëve të duket me të vërtetë e tepërt për të lidhur dy njerëz, Presidenti Rugova dhe Blerim Svirca, aq larg në kuptim të origjinës, përvojave të jetës dhe moshës) me Presidentin e Kosovës dhe gjithë operacionin e deleguar, Svirca mund të shpenzojnë emrin e institucionit që ai pretendonte se përfaqësonte dhe mund të nxirrte kredi dhe ndihmë në Kasabank.

Për këtë arsye dhënien e kredisë (ose overdrafti, siç është theksuar nga dëshmitar Latif Islami) ishte një dukuri e rrallë dhe e jashtëzakonshme, ekskluzivisht në bazë të rrethanave personale dhe në asnjë mënyrë në lidhje me analizën e bazës ekonomike të veprimit.

Është një veprim i pakuptueshëm, në të cilin shkeljet e rregullave bankare dhe të rregullave të kuptim të mirë ka njëra. Ky është rasti për mungesë të dokumentacionit dhe për mungesë të kolaterales. Një është rasti për dhënien e kredisë për kompaninë (Italkosova) llogaria bankare e të cilës tregonte shifra të kuqe, menaxheri (Blerim Svirca) i të cilës ishte paditur nga banka për mospagesë të parave që më parë janë huazuar nga e njëjta bankë. Pakuptueshmëria e procedurës së tërë është konfirmuar nga rrethanat, të përmendura më lart, se kthimi i parave të Italkosova nga Auto Park Loeningen ishte urdhëruar nga i njëjti, Svirca.

Kjo anë e historisë është e dokumentuar në mënyrë adekuate. Në dosje të emruar "Banka 1", i gjithë dokumentacioni i bankës është mbledhur dhe rënditur. Dokumentacioni është i lehtë për t'u konsultuar, i lehtë për të lexuar dhe kuptuar. Duke pasur parasysh natyrën e saj zyrtare, kjo nuk është e kontestueshme.

Vlen të theksohet se, në mesin e të akuzuarve, vetëm Blerim Svirca merr pjesë në këtë pjesë të ngjarjeve. Mujë Ukaj, Nexhat Shatri, Qelser Baholli nuk janë përmendur në dokumentet apo nga dëshmitarët e gjyqimit. Që të dy, Hashim Deshishku dhe Latif Islami përmendin se e kanë njohur ekskluzivisht Blerim Svircën, si një afarist, i cili kishte kontakte me institucionin financiar, si një partner profesional. Mystaf Avdyli nuk u pyet në lidhje me njohuritë e tij me të akuzuarit, por dëshmia e tij është përqëndruar qartë në kredinë e dhënë Blerim Svircës dhe nuk shkon përtej kësaj.

Ne e lëmë këtë pikë ashtu siç qëndron tani për tani. Por në një fazë të mëvonshme, do të jetë e përshatshme që t'i çasemi përsëri, në mënyrë që të përshtrujmë disa konkludime në rindërtimin e tërë të fakteve.

- - -

Përveç eksponimit të lëshimeve financiare, dëshmitari Hellbruek vuri në dukje rezultatet e hetimit të tij në aspektet procedurale të blerjes së automjeteve.

Ai i përshkroi dy procedura të dallueshme, do të thotë procedurën e blerjes së automjeteve në Gjermani, me ndërmjetësimin e Michael Sawatzki, në njërin anë, dhe procedurës së prokurimit në ZPK, në anën tjetër.

Aktori kryesor i procedurës së parë ishte Blerim Svirca. I deleguar nga Qelser Baholli me autorizimin e datës 17 Mars 2005, ai udhëtoi për në Gjermani, ku ai u takua me Xhevdet Nikqin dhe Michael Sawatzki më 18 Mars 2005 në mënyrë që të arrijnë marrëveshjen për blerjen e automjeteve të blinduara.

Lidhur me përmblajtjen e takimit, deklaratata e Michael Sawatzki është në dispozicion. Në deklaratën e siguruar përmes Bashkëpunimit Ligjor Ndërkombëtar dhe të konstatuar si të lexuar në procesverbal pas vendimit të Tryptit Gjyqës të datës 7 Tetor 2010,

Name: *A Svirca final Judgment_EA*

Translated by: *IV 1-*

Phone: *4080*

17, VR 18-34

Page: 17 of 36

dëshmitari shpjegoi rolin e Svirçës dhe Nikqit në negociatat për blerjen e automjeteve të blinduara. Sawatzki ishte kontraktuar si pikë kontakti me furnizuesin amerikan, Alpine Armouring, për të cilat Sawatzki kishte punuar më parë. Në rrjedhën e takimit, siç përmend Sawatzki, Svirca ekspozoi dy dokumente, (i) dmth autorizimin e tij për të negociuar dhe për të blerë makina dhe (ii) një kopje të faqes së internetit të kompanisë Armouring Alpine. Blerësi (ashu siç e cilësoi veten Svirca, siç përmendet nga Sawatzki) kërkoi nga Sawatzki të kontaktojë pronarin e kompanisë Armouring Alpine, Fred Khoroushi. Gjatë rrjedhës së thirrjes telefonike që pasoi midis Sawatzki dhe Khoroushi, u diskutua disponueshmëria e makinave të kërkuara u diskutua, nga Svirca dhe Nikqi. Në bazë të informacionit të marrë se gjashtë automjetet e blinduara ishin në shitje dhe përputheshin me specifkacionet e kërkuara nga blerësi, Blerim Svirca vendosi t'i blejë ato. Pagesa e gjashtë automjete është bërë më 29 Mars 2005, përmes dy transferave të parave të cekura më sipër, në faqe 14 (për 324.924,80 euro dhe 315.181,75 euro respektivisht), nga një llogari bankare të Auto Parkut Loeningen në Gjermani në llogarinë bankare të Alpine Armouring inc. në SHBA. Alpine Armouring megjithatë, lëshoi fatura dhe rrjedhimisht licenca eksporti në emër të ZPK-së.

Në deklaratën e tij, më tej Hellbrueck vazhdon në rindërtimin e procedurës: ai përmendi se tri ditë pas blerjes së makinave, përkatësisht më 21 Mars 2005, procedura e prokurimit publik ka filluar në ZPK nga Qefser Baholli.

Kërkesa për blerje e dorëzuar në zyrën e zyrtarit të autorizuar, Muje Ukaj², ka genë për katër automjete të blinduara në vend të gjashtë për të cilat veç ishte negociuar dhe u bë marrëveshja në mes të Blerim Svirçës me Fred Khoroushi. Autorizimi për blerje është i datës 24 mars 2005; pastaj në vazhdim ishte dërguar te departamenti i prokurimit brenda ZPK, udhëhequr nga Nexhat Shatri. Më 30 mars 2005, u nënshkrua kontrata në mes të Nexhat Shatrit dhe Ahmet Ademaj, përfaqësuesit ligjor të kompanisë Auto Park Loeningen.

Gjatë zhvillimit të procedurës u bë një hap shtesë me kërkesë për procedurën speciale të prokurimit (procedura me një kontraktues) nga ana e Nexhat Shatrit për Agjencinë e Prokurimit Publik brenda Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Kërkesa dhe aprovimi mbajne të njëjtën datë (24 mars 2005).

Në ditët në vijim, procedura është kompletuar me përpilimin e CPOs dhe pagesave në vazhdim, në rata të ndryshme, të përshkuara më lart, të hollave që ishin për Auto Park Loeningen.

Me arritjen e automjeteve në Kosovë ka përfunduar e tërë skema.

Katër automjete të blinduara të blera nga ZPK janë dërguar në Gjakovë. Automjetet kanë genë të përcjella me dokumentacion origjinal nga furnizuesi amerikan i automobilave, Alpine Armouring inc., duke treguar shumën e përgjithshme prej \$ 828,734 (\$ 692,759 dhe \$ 135,975 në dy fatura) për gjashtë automjete të blinduara. Gjithashtu

² Dokumenti është në fashkull, pg.

dokumentacioni i eksportimit ka treguar dukshëm çmimin e njëjtë dhe numrin e automjeteve.

Pastaj automjetet i janë prezantuar zyres kompetente të doganës. Procedura administrative për hyrjen e mallit në Kosovë dhe pagesa e taksës së importit nuk ishte bërë me arritjen e mallit (aerporti i Gjakovës, ku malli është sjell, është aeroport ushtarak dhe nuk ka zyre të doganës). Procedura u krye në zyrën kompetente në Pejë.

Automjetet nuk janë prezantuar me dokumentacionin që i ka përcjellë ato me arritje në tokën e Kosovës por me dokumentacionin e përgatitur në ZPK për blerje të automjeteve nga Auto Park Loeningen.

Oficerët doganor që janë dëgjuar gjatë gjykimit (Mentor Mulliqi, Xhemajl Prekaj dhe Skender Komoni) të gjithë kanë referuar për mospërpunjet në mes të automjeteve dhe dokumentacionit duke pranuar se të gjitha hezitimet dhe pengesa për të spastruar procedurën (kjo është shprehja e përdorur nga dëshmitari Xhemajl Prekaj) janë hequr “pas konsultimit me zyrën kryesore në Prishtinë ... duke e konsideruar destinacionin e tyre të fundit dhe trezikun e ultë ose jo ekzistues se i tërë operacioni kishte rezultuar me dëmtimin e Doganave të Kosovës”.

Mospërpunjet të cilat përbëheshin nga fakti se licenca e eksportit (prova 7 në fashikull 4) ka treguar një numër prej gjashtë automjeteve të blinduara ndërsa kontrata e nënshkruar nga Nexhat Shatri dhe dokumentacioni i përgatitur nga ZPK ka përmendur 4 automjete të blinduara për ZPK. Çmimet e automjeteve dhe standardet teknike gjithashtu kanë ndryshuar.

Shkëmbimi i dokumenteve është përshkruar mirë në depozimin e Hellbrueck (faqja 8 dhe vazhdimi procesverbalit).

Në bazë të rikonstruimit të fakteve të bërë gjerë më tani, tani është koha që të nxirren disa konkluzione lidhur me provat.

Pjesënatrja e Blerim Svirçës në negociata për blerje të automjeteve është konfirmuar me shumë elemente dhe nuk është kontestuar nga i njëjti i pandehur, në deklaratat e fundit që ai i dha hetuesve. Larg nga ajo se ishte vetëm një ndërmjetëse pa rol autonom, ai ishte zgjedhur në këtë pozitë të privilegjuar të mbajtësit të llogarisë bankare në Kasabank dhe person i besueshëm i aksionarit të bankës Hasim Dëshishku.

Shkurtimeisht, ai ka qenë në gjendje që të jep mjetet financiare të nevojshme për të paguar furnizuesin e gjashtë automjeteve (Alpine Armouring inc.). Operacioni financiar ishte bërë nëpërmes të llogarisë bankare të kompanisë së tij Italkosova në dobi të Auto Park Loeningen.

Në të njëjtën kohë, për bashkëpunëtorët e tij në ambientin e biznesit dhe për shkak të njohjes së tij me procedurat e vizave dhe aranzhimeve të udhëtimit³, ai ka qenë i gatshëm që të shërbejë si një përfaqësues i Presidentit në punët specifike⁴.

Lidhur me natyrën e autorizimit të pranuar, vlen të vërehet si në vijim.

Është e pakontestueshme nga avokati mbrojtës dhe nga vet i pandehuri, se 'letra e autorizimit' e datës 17 mars 2005, i atribuohet të pandehurit fuqia që të përfaqësojë dëshirën e Presidentit në negociata për blerjen e disa automjeteve të blinduara.

Dokumenti paraqet aktin formal për transmisionin e fuqisë për negociim nga Zyra e Presidentit të një individ (Svirca) i cili as nuk ka qenë anëtar i institucionit.

Ky është një dokument në të cilin parregullsitë janë të shumta.

Së pari, është nënshkruar nga Shefi i Shërbimit të Sigurimit, i cili nuk është oficer i autorizuar, në kuptim të ligjit mbi Prokurimin Publik. E dyta, objekti nuk është i përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme (ky i referohet 'disa' automjeteve pa specifikim të mëtejshëm). E treta, aly përshihet negociata e automjeteve për 'anëtarët e qeverisë së Kosovës', p. sh. për një institucion tjetër që ishte e jashtme për procedurën e blerjes.

Pa marr parasysh, dokumenti ka pasur një bazë të mjaftueshme për transmisionin e fuqisë për të hyrë në negociatë me shtetë potencial, për shkak të besimit të akorduar ndaj një dokumenti që vinte nga Zyra e Presidentit dhe nga vet Presidenti i Kosovës.

Dokumenti ka qenë i mjaftueshëm për ti mundësuar Svirçës ta prezantojë veten si një person me autoritet për negociatë (në kuptim si parashikon neni 84 paragrafi 1, pjesa e fundit e Ligjit marrëdhëniet detyrimore⁵), në emër të Presidentit të Kosovës, Z. Rugova.

Nga pikëpëshkrimi juridik, nuk është e nevojshme të thuhet se një dhënie aq e madh e pushtetit nuk ka qenë legjitime: kur një entitet publik ose institucion shtetëror është i përfshirë, çfarëdo delegim i pushtetit duhet të bëhet formalisht, me emërimin e një oficeri nëpërmes të një procedure që parashikohet me ligjin mbi Prokurimin Publik.

Megjithatë, kjo nuk e ka penguar Blerim Svirçën që të veprojë në emër autorizimit të deleguar, me bindjen, edhe nga ana e tij edhe nga ana e shtetit të automjetit (Fred Khoroushi, nga Alpine Armouring inc.) se procedura ishte korrekte dhe e mjaftueshme që të caktohen kushtet e kontratës për blerjen e automjetit.

³ Dëshmitari Eliez Nikçi (procesverbali nga dëgjimi i datës 17 shtator), Muje Ukaj, Qefser Baholli (procesverbali 3 nëntor 2010, faqe 45) e konfirmojnë rolin e Svirçës në organizimin e udhëtimit e Presidentit Rugova në Romë për varrimin e Papës Pali II në 2005. Por duhet të vërehet se varrimi i Papës ka qenë maj 2005, dm.th. pas, dhe jo para sulmit në autokolonën e Presidentit Rugova. Svirca e përkujton rolin e tij si koordinator të udhëtimit të Presidentit Rugova në Itali me rastin e beknimit të Nanës Tereze, varrimit të Papës dhe Pushimit veror të Presidentit: deklaratat 17 shtator 2005, faqe 8.

⁴ Për marrëdhëniet në mes të Svirçës dhe Presidentit Rugova, shih procesverbalin e 17 shtatorit 2010, faqe 45: Qefser Baholli: "Blerim Svirca vinte rregullisht të Presidenti Rugova dhe ai kryente punët që i kërkonte Presidenti. Unë kur nuk kam marr pjesë në takimet e tyre dhe nuk e di përmbajtjen e bisedave të tyre. Blerim Svirca ishte afatasi që e kishte kompaninë e vet".

⁵ Ligji i marrëdhënieve detyrimore i Republikës së Jugosllavisë (Zakon o obligacionim odnosima), i publikuar në Gazetën Zyrtare të Jugosllavisë n.29/1978.

Në të njëjtën kohë, dy anët e përfshira në negociatë për blejjen e automjeteve (Svirca dhe Xhevet Nikci në një anë; Fred Khoroushi dhe Michael Sawatzki në tjetrën) kanë genë në djepin e një autorizim i thjeshtë nuk ka genë i mjaftueshëm që të bëhet kontrata me një Institucion Publik dhe se marrëveshja e arritur me gojë duhej të konfirmohej nga një Procedurë të Prokurimit Publik.

Kjo nënkuptohet, në rastin e Alpine Armouring inc.: si një punues i veturave të blinduara dhe si shitës i veturave të blinduara, se një pjesë e rëndësishme e biznesit duhet të gjenerohet nga sektori publik dhe nga blejtet nga entitetet publike për nevojat e tyre institucionale. Përvoja mëson se në rastet e tilla kontratat verbale nuk lejohen dhe se, përkundrazi, gjithmonë është me vend një procedurë që vlerëson nevojat e institucionit dhe që garanton se të hollat publike janë shpenzuar në mënyrë më të mirë të mundshme, në shtetet e ndryshme. Për Khoroushi-n, një biznesmen me përvojë, nuk ka pasur arsye që të besojë që në rastin e Presidencës së Kosovës, një marrëveshje verbale me një person të autorizuar ishte e mjaftueshme.

Sa për Svirçën, ai nuk duhej të injoronte nevojën e një procedure të mëtutjeshme në nivelin e OPK, nëse jo për tjetër, për interesin e tij personal që të kthej të hollat e huazuara te Auto Park Loeningen. Natyrisht, për pozitën e tij si një i autorizuar dhe financiar i tërë operacionit, ai duhej të ishte i sigurt se automobilat do të blihen në fund nga ZPK dhe se huazimi do të kthehet shpejt. Ekspozimi i tij ndaj Kasabankës ka genë i qëndrueshëm dhe i vetmi argument për të bindur bankën që t'i huazojë atij të hollat ka genë besimi se i tërë operacioni do të jetë i suksesshëm që nga fillimi, se nuk ka rrezik as për Svirçën as për bankën, duke e pasur garancinë se ZPK do të jetë blerësi dhe paguesi i fundit. Në këtë kuptim, huazimi nuk ishte parë si një investim, profiti i të cilit ishte i dyshimtë; ishte parë nga Svirca dhe Deshishku si një transferim i thjeshtë i përkohshëm i të hollave, që duhej të kthehej brenda disa ditëve⁶.

Si dihet, Blerim Svirca ka zgjedhur të mbetet i heshtur gjatë ekzaminimit të tij në Gjykatë. Kur u pyet nëse dëshiron të flet ose të mbetet i heshtur, ai u përgjigj: "Kisha dashur të qëndroj pranë deklaratës sime të dhënë më parë dhe sot të mbetem i heshtur"⁷.

Në deklaratën e tij (Svirca u dëgjua në raste të shumta gjatë hetimeve, më 19 korrik, 14 shtator, 26 shtator, 28 shtator dhe 10 tetor 2005 dhe më 16 janar 2006) i pandehuri ka tentuar të portretizojë veten si një ekzekutor i thjeshtë i dëshirës së Presidentit. Për më tepër, ai tentoi të jep imazhin e vetvetes të një instrumenti të padijshëm në duart e Z. Sali Cacak, Këshilltari i Presidentit të Kosovës, që është dërguar në Gjermani me detyrë që të dorëzojë një zart.

Në versionet e fundit të Svirçës, disa ditë pas sulmit në autokolonën presidenciale, atë e kontaktoi Sali Cacak për ekzekutimin e detyrës së përmendur. Për te u organizua një vizë

⁶ Hasim Deshishku, në depozimin e tij me 3 shtator 2006, të konfirmuar në gjykatë me 7 shtator 2010, është përkujtuar se "Svirca ka deklaruar se të hollat do të kthehen nga njëri prej Ministrave të Kosovës".

⁷ Proceverbali nga dëgjimi i datës 8 nëntor 2010, faqe 20.

italiane për të udhëtuar në zonën e Shengenit; në të njëjtën ditë, ai ka blerë dy bileta të aeroplanit për fluturim në Dusseldorf për diën e nesërme me qëllim që të takojë marrësin e zarfit, Xhevet Nikci, një shitës të veturave që ai e ka njohur përiferisht prej vitit 1995.

Në versionin e mëparshëm ai ka përijashtuar përfshirjen e tij në biznes.

Në deklaratën e tij të parë (19 korrik 2005), ai ka mohuar çfarëdo pjesëmarrje ose rol në negociata për blerjen e automjeteve për Presidentin e Kosovës. Ai ka konfirmuar transferimin e shumës prej 800.000,00 Euro prej llogarisë bankare të kompanisë së tij në llogarinë bankare të Auto Park Loeningen, por ka refuzuar të pranojë se ai ka ditur arsyen e kërkesës për të holla,⁸ duke folur për një kërkesë të thjeshtë për të holla nga një shok dhe me telefon. Në të njëjtën deklaratë, ai nuk ka përmendur udhëtimin e tij në Gjermani dhe nuk e lidhë transferimet e të hollave me blerjen e veturave⁹.

Lidhur me shumën prej 340.000,00 euro të pranuar nga Auto Park Loeningen në të njëjtën ditë kthimi i huas (210.000,00 euro të pranuar më 31 mars) dhe më 21 dhe 22 prill 2005 (130.000,00 euro)¹⁰, ai shpjegon se ishte një huazim të cilin ai ka kërkuar nga Xhevet Nikci me qëllim që të blejë tokë “nga një Serb”. Kur u pyet cila tokë, për çfarë çmimi dhe nga kush, Svirca i shmangej përgjigjes, duke thanë se ai nuk ka qenë i interesuar në ndonjë ngastër specifiqe të tokës (kështu, dikush mund të shtroj pyetje pse prej një Serbi?) dhe se kështu projekti për investim u ndërpre, pasi që ai duhej të kthente të hollat Xhevet Nikci në një kohë të shkurtër.

Tani, justifikimet e dhëna nga Svirca (më pak se tre muaj nga faktet) nuk janë vërtetuar dhe janë mezi të besueshme.

Lidhur me huazimin që pretendohet se është pranuar nga Nikci, dikush mund të pyes pse Svirca, i cila ka treguar të jetë në gjendje të pranojë 800.000,00 euro nga banka dhe t’i kthejë bankës brenda një jave (prej 23 marsit gjerë më 31 mars) nuk ka menduar që të kërkojë nga banka drejtpërdrejt. Ai thotë se ai duhej të kthente Nikci huazimin vetëm disa ditë pas pranimit të hollave. Ai tha se ai ka bërë kështu duke tërhequr të hollat nga llogaria bankare ku ato kanë qenë të transferuara (llogaria e Italkosova, nga llogaria bankare e Auto Park Loeningen) dhe duke i dhënë Xhevet Nikci në Prishinë banknotat prej 500,00 euro. Por ky rekonstruim nuk ka kuptim dhe numrat nuk po mblihdhen: Italkosova ka pranuar 210.000,00 euro (përpos 800.000,00 euro të kthimit të huazimit) më 31 mars nga Auto Park Loeningen; 4 tërheqje të hollave—që pretendohet të jenë kthyer Nikci— kanë ndodhur respektivisht më 2 prill (5.000,00 euro), 4 prill (52.900,00 euro), 5 prill (100.000,00 euro) dhe 6 prill (47.000,00) që bën një total prej 204.900,00 euro.

Por pastaj, përsëri, Italkosova ka pranuar nga Auto Park Loeningen 100.000,00 euro më 21 prill dhe 30.000,00 më 22 prill. Dhe Svirca ka tërhequr të holla të gatshme më 21 prill, 50.000,00.

Afatet kohore të transferimeve të hollave dhe tërheqjet e të hollave të gatshme nuk ndihmojnë versionin të Svirces. Gjithashtu, nëse trupi gjykses besonte (gjë që nuk është rasi) se kthimi i shumës së këllitë të të hollave është bërë nga biznesmenët ekspert me të

⁸ Shih, përkundraz, deklaratën e Dëshishkur, të përmendur në fushnotën e parë të faqes së kaluar.

⁹ Faqe 2 e deklaratës të 19 korrik 2005: “Pyetje: A kjo diçka të bëj me veturën e kërkuar të Presidentit Rugova? Përgjigja: Jo. P.:

A keni qenë ju në ndonjë mënyrë i përfshirë me këto vetura? P.: Jo”.

¹⁰ Më lartë, faqe 15.

holla të gatshme dhe pa e nënshkruar një vërtetim, nuk ka kuptim që të hollat e huazuara (210.000,00 euro) të kërkohen të kthehen brenda më pak se një jave, në *deger* e ndryshme dhe vazhdohet, pas vetëm dy javëve, nga një transferim tjetër i të hollave në të njëjtin drejtim (Auto Park Loeningen – Italkosova). Në intervistën e dytë, të mbajtur më 17 shtator, ai ka justifikuar kthimin me para të gatshme sepse llogaria bankare e Auto Park Loeningen ka qenë e bllokuar nga Autoritetet Gjermane. Por, sikur që shihet në dokumentin e datës 21 maj 2005 (Memorandumi për Prokurorin Ndërkombëtar, i përgatitur nga Hetuesi Hellbrueck) të dy llogaritë bankare të Auto Park Loeningen, në Gjermani në Kosovë, kanë vazhduar të operonin shumë pas datës së kthimit të pretenduar të hollave Nikçit. Me rastin e ekzaminimit të dytë, më 17 shtator 2005, Avokati mbrojtës i Blerim Svirçës, Znj. Nektbe Kelmendi, ja ka dorëzuar Prokurorit një deklaratë të bërë përpara një noteri Gjerman (gjysma në gjermanisht dhe gjysma në shqip!), ku Xhevdet Nikçi ka konfirmuar se ka dhënë si huazim 340.000,00 Blerim Svirçës dhe se ka pranuar të njëjtin shumë të kthyer nga ai. Deklarata në fjalë nuk ka kurrfarë kredibiliteti dhe tregon njërin prej aspekteve kryesore të mënyrës së mbrojtjes së Blerim Svirçës, të bazuar në tentim të krijimit të një prezantimi të rrejshëm për të fshehur të vërtetën.

Dokumenti nuk është i besueshëm për shkak dy arsyeve.

E para, vjen nga personi që ka pranuar përfitimin më të madh nga i tëtë operacioni mashtrues në dëm të ZPK (ka qenë nëpërmes të kompanisë së tij Auto Park Loeningen që ka komercializuar veturat në Evropë dhe ka qenë ai që ka pranuar në mënyrë disproporcionale pagesën e lartë për automjetet që kanë pasur çmimin më pak se gjysma së çmimit të shpenzuar nga ZPK për blerjen e tyre).

E dyta, dokumentet vërtetojnë me një saktësi të lartë: në to, Nikçi deklaroi se ka pranuar të hollat e kthyer në shumë të njëjtë që ai ka dhënë si huazim Svirçës (340.000,00 euro). Por, sikur që shihet më lart, Svirca ka tërhequr të hollat e gatshme nga llogaria bankare e Italkosova 80.000,00 euro më pak se 340.000,00 që ai ka pranuar. Pëpos kësaj, tërheqja e fundit (50.000,00) është bërë të njëjtin ditë (21 prill) kur rata e dytë (100.000,00 euro) e huazimit të pretenduar u transferua te Svirca. Dhe një ditë përpara pjesës së fundit të 340.000,00 ishte dhënë.

Kjo është e mjaftueshme që të tregojë se Svirca nuk ka tërhequr të hollat për t'i kthyer ato Nikçit.

Deklarata e Xhevdet Nikçi, prandaj, nuk është e besueshme; duhet të merret si një favor i bërë nga Nikçi për Svirçën, në tentim që të vërtetojë mbrojtjen e të pandehurit me një deklaratë të rrejshme.

Si përfundim, gatishmëria e Nikçit që të nënshkruaj një deklaratë të rrejshme me qëllim që jep arsyetimin shpjegimit të Svirçës mbi transferimin e të hollave dhe të tërheqjet, është një tregues i solidaritetit që ekziston në mes atyre dyve.

Sikur që u tha, ka qenë 10 tetori kur Svirca ka pranuar, nëse edhe në kuptim shumë të zvogëluar, pjesëmarrjen e tij në negociata paraprake për blerjen e automjeteve.

Në deklaratat e mëparshme (19 korrik, 17, 26 dhe 28 shtator) i akuzuari ka refuzuar që të pranojë ose ka preferuar që të mbetet i heshtur dhe mos të përgjigjet në intervistë, kur ishte pyetur pyetjen specifike (“a keni marr pjesë në blerjen e automjeteve për ZPKP?”) ose kur ai ka ndier se marja në pyetje ishte duke e marr atë drejtim.

Është e qartë kur thuhet (argumenti ishte përdorur nga Avokatët Mbrojtës të Pandehurit gjatë ekzaminimit të 10 tetorit 2005, me qëllim që t'i përgjigjet pyetjes së prokurorit: “Pse nuk më keni thënë këto gjëra që nga intervista e parë?”) se “i pandehuri ka të drejtë të ndërroj deklaratën e tij dhe ... ai ka të drejtë të mbetet i heshtur”.

I pandehuri nuk flet nën betim; ai mund të gënjëjë ose mund të preferojë të mbetet i heshtur. Ky është një aplikim fundamental i parimit “*nemo tenetur se delegee*” (privilegj kundër vetë-akuzimit, thënë gjithashtu si liria nga vet-inkriminimi¹¹) e cila gjendet në legjislacion, në nivelin e Kushtetutës¹² dhe në nivelin e legjislacionit të rëndomtë,¹³ konfirmim pozitiv. Ky parim domethënë se i pandehuri i cili nuk e thotë të vërtetën ose preferon të mbetet i heshtur, nuk mund të lëndoj nga pasojat negative të zgjedhjes së tij/saj.

Sidogotfë, ky parim nuk mund të interpretohet në kuptim të pengimit të gjykatësit që të nxjerrë konkluzionet nga ndryshimi i versionit nga ana e të pandehurit.

Dhe në konkludimin specifik që mund të arrihet në rastin specifik është se fshehja e Svirçës mbi përfshirjen e tij është e motivuar nga dëshira e tij për të minimizuar dënimin dhe rolin mbi faktet, në dënimin se zbulimi i dimensionit të vërtetë mbi pjesëmarrjen tije (pjesëmarrja në negociata në një anë; prokurimi i fondeve për tërë operacionin, në anën tjetër) do të kishin keqësuar pozitën e tij si i akuzuar.

Nga fjalët e Sawatzki-t¹⁴ (i cili, si ndërmjetësues ka qenë i paguar nga Alpine Armouing, dhe është një dëshmitar që nuk ka ndonjë interes specifik në hetime dhe për atë është i besueshëm) Trupi Gjykses ka mësuar se Blerim Svirca ka pasur një rol vendimtar në negociata. Kontributi i të pandehurit nuk mund të zvogëlohet në atë të poshterit që i dorëzon një dokument Xhevdet Nikqit, sikur që pretendonte Svirca deri në fund.

Autorizimi i nënshkruar nga Qefser Baholli ka qenë në favor të Svirçës, e jo të Nikqit.

Përpas kësaj, dokumentet e konfiskuara nga shtëpia e Svirçës, më 19 korrik 2005, p.sh. 2 printime të modeleve të ndryshme të veturave të blinduara me çmime dhe më konfiguracione të ndryshme, tregojnë se Blerim Svirca nuk ka qenë një ekzekutor i thjeshtë i kërkesave të Sali Cacajt.

Tani, sigurisht se është e mundur që Svirca nuk ka qenë një pjesëtar i shkëmbimit të informacioneve fillestare dhe të marrëveshjeve në mes të Këshilltarëve të Presidentit të Kosovës (i përmenduri Cacaj dhe Këshilltari i Sigurimit të Presidentit, Ramë Mara) dhe të Xhevdet Nikqit¹⁵ mbi numrin e veturave për të u blerë dhe karakteristikave të tyre dhe

¹¹ Në kufirin e saktë të parimit të nxjerrë nga neni 6(1) të ECHR ruajtur në nenin 14(3)(e) të ICCPR, shih *Saunders v UK 1996-IV*, 23 EHRR 313 para 68 GC, *Murray v UK 1996-I*; 22 EHRR 29 para 46 GC.

¹² Neni 30.1, 6.1 Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kushido që ngarkohet për vepër penale do të gëzojë këto të drejta minimale...

¹³ (6) të mos të deprohohet që dëshmoj kundër vetvetes apo të pranoj fajësinë.

¹⁴ neni 11.2 KPPK: i pandehuri nuk do të obligohet... të përgjigjet në asnjë pyetje dhe ... nuk do të obligohet që të inkriminon vetveten apo të qënimin e tij apo të pranon fajësinë.

¹⁵ Deklarata

¹⁶ Për thirrjet telefonike në nivelet më të larta, shih faqen 12.

mbi çmimin e tyre. Sidogofte, provat e mbledhura nga Prokurori tregojnë se ai menjëherë u bë pjesëtar i grupit që ka udhëhequr biznesin dhe atij iu akordua një status special i besimit, për rolin e tij, lidhjet e tija familjare¹⁶, njohjen e tij me Xhevdet Nikqin dhe për karakterin e tij dinamik.

Le të kthehemi tani te të pandehurit Muje Ukaj dhe Nexhat Shatri.

U kuptua se në rekonstruksimin e fakteve nga Prokurori, kurrë nuk është supozuar ekzistimi i një marrëveshjeje kriminale të drejtuar kah mashtrimi i buxhetit të ZPK-ës nga ana e anëtarëve të stafit të së njëjtës ZPK. U kuptua se akuza për shpërdorimin e zyrës ose pozitës nuk është e lidhur direkt me avantazhin e trashëguar të Muje Ukajt, e veçanërisht të Nexhat Shatrit.

Dhe natyrisht, hetimet nuk kanë ekspozuar asnjë lidhje në mes të atyre treve ose në mes të tyre, Svirçës dhe/ose Xhevdet Nikqit, gjë që mund të mbështetë pretendimin mbi skemën mashtruese ose ndonjë marrëveshje për ndonjë profit të paligjshëm në dem të buxhetit të ZPK-ës.

Hulumtimet në këtë drejtim janë bërë në mënyra të mundshme (përgjimet e telefonit/ zbulimi i të dhënave financiare). Por ato nuk kanë sjellë deri te asgjë e rëndësishme.

Ky profil reflektohet në formulimin e aktakuzës, ku një avantazh i mundshëm personal i njërit apo më i madh i njërit prej tre të akuzuarve nuk përmendet ose nuk përshkruhet.

Duke e bërë këtë, kuptohet, Prokurori ka hequr dorë nga sjellja e ndonjë prove mbi një interes të mundshëm personal në punën e Muje Ukajt, Nexhat Shatrit dhe Qetser Bahollit.

Ky konfigurim i akuzës, megjithatë, ka rezultatet veta.

Në mungesë të ndonjë elementi të përfundimit material të qëllimshëm për kryesin e pretenduar, për ndonjë individ tjetër ose për një organizatë të biznesit, ose të ndonjë dëmi të qëllimshëm të shkaktuar dikujt ose ndonjë organizate të biznesit, aplikimi i dispozitës së nenit 339 KPK është qartë problematik.

Me qëllim që të dallohet një shpërdorim penal nga neglizhenca e parrezikshme në ushtrimin e një pushteti publik ose nga ndonjë lloj i marrjes së parregullt me funksione publike të lirë nga relevancë penale, është e domosdoshme të ekzistojë intenca specifike e marrjes së një përfundimi material ose dëmtimit të dikujt ose të një organizate.

Intenca specifike përban esencën, parametritin që e kualifikon një sjellje përndryshe të padallueshme dhe të përgjithshme si një veprë penale. Nëse mungon intenca specifike, është i pakuptimtë keqpërdorimi i një funksioni publik që mund të paraget shpërdorimin; ky mund të reduktohet në një sjellje të gabuar që nuk i shërben ndonjë qëllimi; është një gabim që, sikur të gjitha gabimet, nuk është bërë me qëllim.

¹⁶ Baba i tij ka qenë mjeshtr për të gjitha i Familjes së Presidentit (shih deklaratën e Svirçës të datës 17 shtator 2005, faqe 8; ekzaminimi i Muje Ukaj dhe Qetser Bahollit); Svirca e paraget vetën si i afërri deri në një shkallë me LDK, partia politike e udhëhequr nga Presidenti Rugova (deklarata e 17 shtator 2005, faqe 10).

Me fjalë tjera, është veshiturë (dhe e mos-përpunshme me nenin 339 të KPK) të imagjinohet një shpërdorim që është bërë me qëllim por pa pasur cakun e caktuar, p.sh. pa një intencë specifike.

Lidhur me këto premisa, sjellja e dy oficerëve të ZPK duhet të kualifikohet përsëri.

Faktet e përshkruara në aktakuzë lidhur me Muje Ukajn dhe Nexhat Shatrin janë vërtetuar kryesisht.

Të dytë, në funksionet e tyre gjegjëse të Sekretarit të Përgjithshëm të ZPK dhe të Shefit të Zyrës së Prokurimit të ZPK, kanë përgatitur letrat për procedurën prokurimit për blerjen e katër automjeteve të blinduara dhe dy automjeteve të pa blinduara. Me qëllim që të bënin këtë, dhe ta bënin në mënyrë të shpejtë, ata kanë imponuar autoritetin e tyre mbi varësit e tyre, kanë përshejtuar procedurën në një mënyrë që nuk ka lënë ndonjë vend për refleksion, ata kanë vrapuar si të verbër për të zbatuar atë që ata e kenë parë si dëshirë të pakontestuar të eprorëve të tyre.

Duke e bërë këtë, ata kanë harruar kujdesin e obligueshëm.

Të bindur se kryerja e detyrës së tyre profesionale në mënyrë korrekte përbëhej në ekzekutimin e verbër të cilitdo vendim që vinte nga lart, ata kanë harruar çfarëdo shqyrtimi, vlerësimi të lehtësimit ose të legjitimitetit të blerjes.

Kur kërkohet nga Presidenti, ata nuk kanë genë në gjendje që të përdorin asnjë shkallë të lirisë së veprimit. Ky është një proces i shfuqizimit të personalitetit dhe përgjegjësisë individuale, bazuar në besimin absolut ndaj eprorit.

Por, sikur ka vërejtur Hellbruek në deklaratën e tij¹⁷, “arsyeja për procedurat e prokurimit në ligjin mbi prokurimin publik është vetëm që të shmanget ose parandalohet një gjuajtje e tillë e të hollave”¹⁸.

Fakti që Muje Ukaj dhe Nexhat Shatri kanë tentuar të validojnë këtë porosi të veturave pranuar të bëjnë prokurimin publik për të blerë atë që veç ishte vendosur në nivelin Presidential (dmth. në mes të Presidentit ose këshilltarëve të tij Cacajt dhe Marajt, në një anë, dhe Xhevdet Nikqiri, në anën tjetër) kishite domethënie se çfarëdo mundësi për paraqitjen e interesit publik në procedurë ka genë e përjashtuar. Procedura e prokurimit publik, në atë pikë, ka genë e pavlefshme: nëse kontrata veç ka genë e përfunduar (kerret veç janë paguar *përpara* fillimit të procedurës, më 24 mars), pse të fillojë procedura? Në atë moment procedura ka genë një tallje. Deri në fund, Muje Ukaj me kokëfortësi ka treguar paafësinë e tij për të kuptuar ku e ka kryer shkeljen. Deri në fund, ai deklaronte

¹⁷ Procesverbali i dëgjimit të datës 7 mars 2006, faqe 4.

¹⁸ Koncepti i njetë i shprehur me fjalët nga Seksioni 1 (Në Titullin 1, Kapitulli 1) Ligji mbi prokurimin publik të Kosovës, 2003/17 thotë si në vijim: “Qëllimi i këtij ligji është që në mënyrën ma efektive, më të lirë, transparente dhe të drejtë të siguroj përdorimin e fondeve publike, mjeteve publike dhe çfarëdo fondi apo mjete të autoriteteve kontraktuese të Kosovës...”

mbi përmbajtjen e formularëve, respektimin e tij ndaj ligjit të shkuar mbi prokurimin publik.

Lëshimi i kujdesit të obliguar nga dy officerët ka shkaktuar një dëm ndaj ZPK.

Mujë Ukaj dhe Nexhat Shatri refuzuan (ose më mirë as nuk kanë tentuar) të hulumtojnë opionet e ndryshme në dispozicion në treg për mallrat e njëjta.

Të Pandehurit dhe Avokatët e tyre Mbrojtës gjegjës kanë parashtruar disa argumente mbrojtëse, lidhur me këtë pikë. Ata kanë thënë se (i) atëherë ka qenë nevoja për një furnizim urgjent me mall dhe se (ii) ka qenë procedura me një agjenci kontraktuese. Pëpos kësaj ata kanë thënë, (iii) procedura, ashtu si është kryer, ka qenë e aprovuar nga autoriteti kompetent (Agjencia e Prokurimit Publik e Ministrisë së Financave dhe e Ekonomisë).

Këto argumente nuk janë të bazuara, sipas opinionit të Trrupit Gjykses.

Pëderisa është e pakontestueshme se çështja ishte urgjente, kjo nuk lejon lëshimet të cilësdo procedurë dhe nuk i autorizon zyrtarët (Sali Cacajn dhe Rame Marajn, në rastin specifik) të cilet nuk mbajnë kualifikimin e zyrtarëve të autorizuar dhe që janë të jashtëm për Zyrën e Prokurimit, që të negociojnë blerjen e automjeteve për ZPK, duke vendosur për modelin, dhe markën numrin e veturave për të u blerë.

Në mënyrë analoge, arsyet për urgjencë nuk e paragesin një justifikimin për Mujë Ukajin dhe Nexhat Shatrin që të abstenojnë nga kryerja e detyrës së tyre gjegjëse dhe me një kujdes të obligueshëm.

Neni 3 (Përijashimet) i Ligjit mbi Prokurimin Publik thotë se: “3.1 Pa cenuar asnjë dispozitë të këtij ligji, nga autoriteti kontraktues nuk do të kërkohet që të *veprojë në përputhje me secilën procedurë të veçantë të prokurimit dhe as të respektoj dispozitat e këtij ligji mbi transparencën gjër në shkallën kur, përputhshmëria dhe respektimi do të komprometohin sekretin e ligjshëm ose interesat e sigurisë gjatë kryerjes së aktiviteteve të prokurimit të rëndësishme për dhënieën e një kontrate publike për të cilën PSSP-ja dhe Kryeministri janë pajtuar që ta përijashtojnë nga fashëveprimi i këtij ligji sepse (i) ekzekutimi i kontratës në fjalë, sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë, kërkon përdorimin e masave të veçanta të sigurisë, ose (ii) PSSP-ja dhe Kryeministri janë pajtuar që ta klasifikojnë lëndën e kontratës në fjalë si sekret”.*

Dispozita e cila përijashton procedurat e rëndomta, nuk aplikohet në rastin aktual, për shkak të arsyeve të qarta.

Pëpos kësaj, Ligji mbi Prokurimin Publik parashih përijashimet nga rregulla e definuar në Nenin 30 (procedurat e hapura në zhvillimin e veprimeve të prokurimit që çojnë deri te fitimi i një kontrate publike). Ato janë definuar në nenin 31 (Procedurat e Kufizuara) dhe në nenin 34 (Procedurat e Negociuara pa Publikimin e një Njofitimi mbi Kontratë).

Të dy nenet, në mënyra të ndryshme, parashohin përfashimin e procedurës së hapur, nëse ekzistojnë disa rrethanat.

Në rastin e parë (Neni 31) lejohet një procedurë e kufizuar “nëse Zyrtari i Prokurimit të caktuar, në bazë të faktorëve që objektivist verifikohen dhe pa asnjë intencë të diskriminimit, e bie një vendim me shkrim se: a. produkti i caktuar, shërbimi ose punimet – me arsyeim të natyrës së tyre/tij shumë të ndërlikuar ose të specializuar – mundet vetëm të furnizohet, jepet ose kryhet nga një operator ekonomik që ka kapacitet adekuat teknik, profesional dhe/ose financiar”. Kjo qartë nuk u përsërit në rastin specifik: aty nuk ekzistojnë “faktorët objektivist të verifikueshëm” që tregojnë se një shitës i automobilitave i dorës së dytë në Gjermani ka genë i vetmi mbajtës i kapacitetit adekuat teknik, profesional dhe/ose financiar”.

Në rastin e dytë (Neni 34) “34.2 Një autoritet kontraktues mund të kërkojë autorizimin për të përdorur procedurat e negociimit pa publikim të mëparshëm të një njoftimi mbi kontratë për të zhvilluar një veprim të prokurimit duke e pasur si objekt të saj fitimin e:

a. ndonjë kontratë publike:

(i) nëse, për arsye objektive dhe të detyrueshme teknike ose artistike, kontrata duhet të jepet një operatori të caktuar ekonomik;

ose

(iv) nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivist të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedure tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t’u atribuohen (mvishen) veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.

Dispozita në vazhdonim i përgjigjet qartë situatës në të cilën Muje Ukaj dhe Nexhat Shatri kanë iniciuar procedurën e prokurimit për blerjen e automjeteve të blinduara.

Është e pakontestueshme se aty kanë ekzistuar ‘arsyet e urgjencës së madhe që dilte nga ngjarjet që objektivist kanë genë të verifikueshme e që në mënyrë të arsyeshme nuk kanë genë të parashikueshme nga autoriteti përkatës kontraktues”.

Sidoqoftë, me pranimin pasiv të vendimit të marr në lartë, të dytë, Muje Ukaj dhe Nexhat Shatri kanë bërë lëshimin e obligimeve të tyre të parashikuarat në paragrafin e fundit të Seksionit 34.

Seksioni 34.9 thotë: “Ekzekutimi i një procedure të negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës në asnjë mënyrë nuk e hiron autoritetin kontraktues nga detyrimi i tij që (i) të luajë një rol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës, veçanërisht sa ka të bëjë me çmimet, afatet e pranimit, sasi të, karakteristikat teknike dhe garancionet, (ii) të sigurojë që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi përkatës i tregut, dhe (iii) të vlerësojë me kujdes kualitetin e produktit, shërbimit ose punës në fjalë.”

Dy të punësuar të ZPK, gjegjësisht Zyrtari më i Lartë Autorizues (CAO) dhe ZP (zyrtari i prokurimit) kanë shkelur dispozitën sepse ata nuk kanë marr asnjë rol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës, me referencë speciale ndaj çmimeve; ata nuk janë siguruar se çmimi i

kontraktuar nuk ishte më i lartë se çmimi në treg; ata nuk kanë hetuar ose nuk janë munduar të kuptojnë nëse sasia e automjeteve i përgjigjej nevojave të ZPK.

Sikur ata të kishin kryer detyrën e tyre, ata do të kishin definuar kushtet e kontratës dhe nuk e kishin marr atë të gatshme nga Qefser Baholli dhe Ahmet Ademaj; sikur ata të kishin definuar kushtet e kontratës me referencë speciale ndaj çmimeve ata së paku do të kishin tentuar të kuptonin nëse çmimi i treguar në kontratë ka pasur kuptim fare ose a ka qenë i tepruar; ata e kishin kuptuar menjëherë se çmimi i secilit automjet ka qenë shumëfish më i madh se çmimi i tregut; në fund, ata kishin parë se numri i kerreve që ishte blerë ka qenë i pakuptimit.

Në fund, veçanërisht, mund të jetë opinioni i Muje Ukajt¹⁹ se cilido numër, model ose markë e kerreve që ka kërkuar Presidenti i Kosovës, ato kërkesa duhej të ekzekutoheshin sepse ishin dëshirë e Presidentit dhe për shkak se sigurimi i Presidentit ishte në pyetje. Megjithatë, është e qartë se dispozita e Ligjit mbi Prokurimin Publik nuk do të kishte lejuar një praktikë të tillë: për shkak se ishte e jashtëzakonshme, procedura e paraparë në seksionin 34 nuk mundet logjikisht të aplikohet përtej domosdoshmërisë së lartë. Në rastin specifik, kjo nuk kishte mundur të aplikohet për blerjen e gjashtë kerreve, domethënë mbi numrin e kerreve lartësisht të nevojshme për sigurimin e Presidentit menjëherë pas sulmit ndaj kerrit të Presidentit. Natyrisht, dikush mund të thotë, kush mund të vendos se cili ishte numri i kerreve, nëse jo vet Presidenti, i ndihmuar nga Këshilltari i Sigurimit Rame Maraj dhe Këshilltari Politik, Sali Cacaj? Si mundet gjykatësi të vlerësojë për nevojën e institucionit më të lartë në Shtet?

Përgjigja është njëft e thjeshtë. Kjo tregohet me dy dokumente.

I pari është autorizimi i 17 marsit 2005, dorëzuar nga Baholli për Svirçën, ku Svirçës i besohet autorizimi që të negociojë për blerjen e automjeteve edhe për 'anëtarët e qeverisë së Kosovës'. Tani, qeveria e Kosovës është një institucion i ndryshëm nga ZPK. ZPK nuk duhej të vendoste në emër të Qeverisë dhe nuk duhej të ngarkonte buxhetin e ZPK për blerjen e mallit të përdorur nga institucioni tjetër. A ka qenë e konsultuar zyra e Qeverisë së Kosovës? Kush ka bërë vlerësimin e urgjencës dhe të rrezikut nga sulmi mbi anëtarët e Qeverisë? Në esencë, dokumenti tregon se standardet e përmendura të nenit 34.9 të Ligjit mbi PP nuk janë marrë në konsideratë dhe se e tërë procedura ishte kryer me marramendje dhe me abuzim. Si konkluzion, këtu tregohet se arsyet për urgjencë kanë ekzistuar vetëm pjesërisht.

Ekzistojnë dokumentet që tregojnë, përtej çfarëdo dyshimi, se blerja e gjashtë automjeteve ka qenë e tepruar dhe se kushtet për blerjen e kerreve me lëshimin e publikimit të njoftimit mbi kontratë nuk kanë qenë të plotësuar.

Ato kanë qenë kërkesat e shefit të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe pastaj të aprovuara nga shefi i Administratës së ZPK për përdorimin e dy Hummers të blerë me të njëjtin rast dhe me të njëjtën procedurë të përdorur për blerjen e katër Chevys të blinduara. Këto të shënuara më lartë, dy automjete të blinduara nuk kanë qenë të përdorura nga ZPK. Ato kanë qenë të parkuara diku në një garazh të marr me qira dhe të paguar nga ZPK dhe të lëna aty për të pushuar derisa të kërkohej nga TMK për nevojat e

¹⁹ Procesverbali i dëgjimit të datës 3 nëntor 2010, faqe 10 dhe të tjera

tyre. Si është e mundur të deklarohet se ishte imperativ të blihen dy Hummers për ZPK, nëse ato nuk janë përdorur kurrë? Pse janë blerë ato nëpërmes të procedurës urgjente të parapartë me Seksionin 34 LPP, nëse ato janë lënë të papërdorura me vite? Dhe në fund, duke supozuar se ka genë e nevojshme blerja e shpejt e kerreve të blinduara për sigurimin e jetës së Presidentit të Kosovës, pse janë blerë me të njëjtën procedurë dy kerre të pa blinduara?

Pamundësia për të gjetur një përgjigje logjike në pyetjet e sipërme tregon se argumentet e parashtruara nga avokatët mbrojtës janë të pabaza.

Trupi Gjykses është i mendimit se blerja e dy Hummers dhe disa kerreve të blinduara ka genë e tepruar dhe ka shkelur parimet e Ligjit mbi Prokurimin Publik.

Vendimi për të filluar procedurën pa një procedurë të hapur dhe pa një shqyrtim të duhur të kushteve kontraktuese është bazë e dëmit të shkaktuar ndaj buxheut të ZPK për shkak të pagesës së tepërt të paguar për mallrat.

Cila është madhësia e dëmit?

Shuma e humbjes e shkaktuar ZPK-ës me këtë veprim mund të përmblihdhet me operacionin vijues.

Nëse X është dëmi, Y janë të hollat e shpenzuara nga ZPK për blerjen dhe Z është çmimi fillestar i kerreve të blera nga Auto Park Loeningen nga Alpine Armouring. Në të njëjtin ekuacion, J paraget dërgesën shtesë dhe K është një zbritje për çmimin e shërbimit potencial të ndërmjetësimit që ndërmjetësuasi në blerje (Auto Park Loeningen, jo Svirca) duhej të kishte kërkuar në mënyrë legjitime.

$$K = Y - (Z + J + K)$$

Kur ne e dimë se

$Y = 1.489,499,72$ (shuma e përcaktuar nga ZPK në ZQP-n dhe e transferuar në llogarinë bankare të Auto Park Loeningen)

$Z = 639,800,00$ (shuma e treguar në fakturat e dëguara nga Alpine Armouring. Çmimet janë treguar në dollarë dhe në euro –që është marr si parametër)

$J = 11,000,00$ (sipas dëshmisë së dëshmitarit Hellbrueck, procesverbali 13 mars 2006)

$K = 64,000,00$ (shuma është përcaktuar sipas lirisë së veprimit nga ana e Trupit Gjykses: nëse edhe standardet e biznesit të rëndomtë kufizojnë çmimin e shërbimit të ndërmjetësimit me një përqindje modeste të vlerës së kontratës –zakonisht 3/5 % - trethanat specifike të urgjencës dhe të sekretit të rasit justifikojnë një përqindje më të madhe, brenda 10% të vlerës së kontratës; si krahasim dhe për të

kuptuar, çmimi i paguar ndërmjetësesit tjetër në kontratë, Sawatzki ka qenë 44.000,00 euro)

është lehtë të vërtetohet se vlera e X prandaj është 774.699,72.

Kjo paraqet dëmin që ka pasuar ZPK në krahasin me një negociatë që nuk kishte me qenë e ndikuar nga faktorët negativ të përshkruar më lartë.

Në anën tjetër, Trupi Gjykses nuk e konsideron si dëm tatimin-shtesë për importimin e automjeteve me një çmim që artificialisht ka qenë i fryrë. Nëse është e pakontestueshme se me blerje me një çmim më të lartë është menduar një nivel më i lartë i imponimit fiskal mbi këtë operacion, nuk mund të shmanget se nga të ardhurat fiskale ka përfituar Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK). Me fjalë tjera, pasi që buxheti i ZPK është pjesë e BKK, operacioni, nga pikëvështrimi ekonomik, ka qenë neutral.

Lidhur me dëmin, një avantazh e ngjashme përputhet për ndërmjetësesin, Auto Park Loeningen.

A e paraqet kjo marzhë ndëshkëmin e ndershëm për aktivitet ndërmjetëses të kryer nga Auto Park Loeningen gjatë negociimit? A mund të thuhet se, nga pikëvështrimi i shitësit gjerman të kerreve, se operacioni është një blerje e rëndomtë dhe e rishijes së automjeteve? Dhe se duke kaluar kah shitësi (Auto Park Loeningen), ky ka qenë i lirë të caktojë çmimin e mallit?

Dhe më tepër, në këto transaksione, cili ka qenë roli i Svirçës? A ka qenë ai një bashkëpunëtor i Xhevdet Nikqit dhe Ahmet Demajt apo a është mbajtur ai jashtë procedurës së negociatave, pa dijeni mbi profitin që shoku i tij Nikqi ka qenë duke e bërë për vetveten në dëm të ZPK?

Trupi Gjykses është i opinionit se madhësia e marzhës është e papajteshme me çfarëdo praktikë të ndershme komerciale dhe justifikohet vetëm në kuptim të mashtrimit në dëm të buxheut publik.

Është konstatuar se nuk është ngritur aktakuza kundër Xhevdet Nikqit dhe Ahmet Demajt në Kosovë as nuk kanë qenë të dënuar në Gjermani, ku ata kanë qenë nën hetime.

Ky argument është i paqëndrueshëm. Mungesa e përfshirjes së pronarit të Auto Park Loeningen në hetimet e UNMIK-ut mund të arsyetohet me interpretim të ndryshëm që ka dhënë Prokurori i UNMIK-ut mbi faktet.

Ose mund të arsyetohet me dëshirën që t'i shmanget rrezikut të *dyfishtë*. Që të dy (Nikqi dhe Ademaj) kanë qenë të ndjekur në Gjermani. Dhe shpallja e tyre si të pafajshëm nga

Gjykata Shtetërore e, Divizioni i 1^{të} i lartë penal, lënda KLS/730 Js 19170/05 – 2/08²⁰ kundër Xhevdet Nikqit dhe Ahmet Demajt për shkak të krimit të mashtrimit dhe të tjera, ekskluzivisht bazohet në vlerësimin e orientuar me çmim dhe në denoncim të mungesës së bashkëpunimit nga ana e Autoriteteve të Kosovës dhe të UNMIK-ut sesa në vlerësimin e fakteve të rasisit dhe në kualifikimin ligjor të akuzave.

Ekziston një shpallje e pajtësisë e bazuar në panjafueshmërinë e provave e cila nuk mund të merret në favor të akuzuarve²¹ si një heqje e përgjithshme e ndalimit nga ndjekja në Kosovë.

Prokurori ka kualifikuar sjelljen e Svirçës si shpëlarje e të hollave, duke shkelur seksionin 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2 dhe sjelljen e tre të pandehurve tjerë si shpërdorim i pozitës zyrtare, duke shkelur nenin 339 të KPK.

Megjithatë, Trupi Gjykses mendon se rikonstruksioni i faktit ashtu sikur që ka dalë gjatë zhvillimit të gjyqimit nuk i lejon këto kualifikime.

Shpëlarja e të hollave përiashtohet për faktin që Svirca, për pjesën e marr në negociata, jo vetëm që ka përfutur të hollat, por ai ka marr pjesë aktivisht në organizimin e tërë operacionit.

Nuk ekzistojnë elemente faktike të mjaftueshme për të vërtetuar një formë të koordinimit në mes të Svirçës dhe të pandehurve tjerë, në kuptim të nenin 23 të KPK. Por ekzistojnë elementet e mjaftueshme për të vërtetuar se ai ka keqpërdorur autoritetin e tij zyrtar të besuar atij me autorizimin e datës 17 mars 2005.

Neni 339 i KPK thotë: “(1) Personi zyrtar i cili, me qëllim të përfimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore ... shpërdoron... pozitën e tij zyrtare... do të dënohet me burgim.

(2)...

(3) nëse vepra penale rezulton me dobi pasurore që tejkalon 5.000 EUR, kryesi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet”.

Neni 107 i KPK thotë se: “(1) Shprehja ‘personi zyrtar’ do të thotë:

1)...

2)... personi i autorizuar në një ... personi juridik, i cili, ... me ... dispozitë të nxjerrë në pajtim me ligji, ushtron autoritet publik, dhe brenda këtij autoriteti ushtron detyra të posaçme.”

Nuk ka fjalë se Presidencia e Kosovës është një person juridik në kuptim të gjerë të parashikuar nga i njëjti nen 107 paragrafi (4) i KPK²²

Blerim Svirca ka qenë i autorizuar të veprojë në emër të Presidentit të Kosovës dhe me autorizim, të lëshuar në pajtim me ligjin, të ushtrtojë një autoritet publik, domethënë të negociojë blerjen e automjeteve për ZPK.

²⁰ Një kopje e vendimit gjyqësorë është dorëzuar gjatë seancës së datës 8 nëntor 2010 nga Avokati i mbrojtjes Troshnja dhe është përkthyer me 22 nëntor 2010.

²¹ Sipas kërkesës së Avokati i mbrojtjes Bajram Imava gjatë seancës së datës 8 nëntor 2010, faqe 22.

²² Termi “personi ligjor” do të thotë... Institucion ... i cili në kuadër të punëve të veia të regullta ... siguron dhe i shpërndanë mjetet”. Në rastin e Presidencës së Kosovës dispozita dhe shpërndarja e mjeteve mund ti referohet marrëdhënieve të punës, kontratës për furnizim, qira e objektit eji që janë të domosdoshme për aktivitetet e zyrës.

Ka pak rëndësi se Svirca nuk ka genë një zyrtar publik dhe nuk ka genë në listën e pagave të ZPK. Koncepti i personit zyrtar dallon nga ai i të punësuarit publik. Natyrisht, në shumicën e rasteve, këto dy koncepte zëvendësojnë njëri tjetrin. Por ato ende ruajnë funksionin e tyre gjegjësisht të ndryshëm dhe autonom. Rrojtari i një objektit publik nuk e ushtron autoritetin publik, në kuptim të nenit 107 të KPK, nëse edhe ai/ajo është në listën e pagave të institucionit publik në të cilin ai/ajo punon. Në anën tjetër, të gjithë personat e zgjedhur/emëruar në funksione ndëri brenda entitetit publik zakonisht nuk paguhen për aktivitetin e tij.

Në cilësinë e tij, Svirca ka negociuar për blerjen e automjeteve, ai ka bërë që mjeket e Auto Park Loenigen të jenë në dispozicion për blerjen e automjeteve nga Alpine Armouring inc., ka pranuar një pjesë të mallit, ka pranuar të hollat që e kishin prejardhjen prej mashtrimit të kryer nga Auto Park Loenigen në dëm të ZPK dhe në fund ka tjetërsuar një pjesë të hollave (340,000,00 euro) duke tërhequr të hollat e gatshme nga llogaria bankare, duke shpërdorur pozitën e tij.

Sa për tre të pandehur tjerë, Trupi Gjykses konsideron se, në fund të gjyqimit, përfshirja e Qefser Bahollit duhet të dallohet.

Nëse edhe emri i tij dhe nënshkrimi është në fund të një numri të dokumenteve (autorizimi, licenca për eksportimin e mallit, në rend të parë), roli i tij dhe pjesëmarrja e tij në ngjarjet duhet të vlerësohet. Për profilin e tij modest (voztës i Presidentit, i promovuar për Shef të Shërbimeve të Sigurimit në rezidencën e Presidentit, por vartës i Këshilltarit të Presidentit për çështjet se sigurimit, Rame Maraj) dhe për nivelin e tij modest të arsimit, sikur që është parë gjatë tërë gjyqimit dhe veçanërisht gjatë ekzaminimit të tij, ai ka genë të paktën ekzekutues i vullnetit të eprorëve të tij. Duket e tepruar që atij t'i vihet një përgjegjësi penale në lidhje me kapacitetin e tij të limituar që të ndikojë në ngjarje ose të marr ndonjë vendim të pavarur. Për shkak të arsimit të tij modest dhe pozitës shoqërore, prej tij është kërkuar që të nënshkruaj dokumentet të cilat ndoshta nuk ka genë në gjendje t'i kuptojë (dokumentet ligjore në gjuhën që ai nuk e flet dhe ai nuk ishte në gjendje që të përgatitet). Ai ka luajtur rolin e një instrumenti në duart e tjerëve.

Mujë Ukaj dhe Nexhat Shatri, në të kundërtën, nuk mund të ankohen se kanë genë në të njëjtën pozitë. Më të aftë nga pikëvështrimi intelektual, ata kanë genë në krye të tërë administratës së ZPK ose të një dege të rëndësishme të saj (zyrtës së prokurimit). Me një nivel të mirë të arsimit dhe të mësuar t'i drejtojnë njerëzit, ata kanë genë në gjendje të kuptojnë se aktiviteti kontraktues të cilin ata ishin duke kryer ka genë në dëm të administratës të cilën ata duhej ta mbronin nga abuzimet.

Nëse edhe kjo nuk lidhej me mashtrim të kryer në dëm të ZPK ose të keqpërdorimit të kryer nga Svirca (ose së paku përfshirja e tyre në këto dy vepra penale nuk ka genë e

Name: *A Svirca final Judgment_EA*

Translated by: *IV 1- Phone: 4080*

17, VR 18-34

Page: 33 of 36

vertetuar) ata kanë kryer veprën penale nga neni 233 të KPK (Veprimtaria e Papërgjegjshme Ekonomike).

Neni 233 thotë: “Personi përgjegjës, në një ... personi juridik i cili, duke e shkelur me vetëdije ligjin ..., vepron në mënyrë të papërgjegjshme dhe me këtë shkakton dëm të konsiderueshëm material ... personi juridik do të dënohet

Në bazë të nenit 107 (2), një person përgjegjës është “një individ në një ... person juridik të cilit për shkak të ... funksionit të tij ... i janë besuar detyrat që lidhen me zbatimin e ligjit ... në qeverisjen ose administrimin e pronës.

Muje Ukaj ka qenë në krye të hierarkisë administrative të ZPK: Nexhat Shatri ka qenë vartësi i tij, shef i përkohshëm i prokurimit. Të dytë kanë pasur funksionet e menaxhimit lidhur me blerjen dhe administrimin e pronës së ZPK.

Nëse edhe dëmi i është shkaktuar ZPK-ës, ky dëm nuk ka qenë i shkakuar me qëllim nga ata, ata me vetëdije kanë lëshuar kujdesin e obliguar të detyruar ndaj tyre me Ligji mbi Prokurimin Publik dhe veçanërisht me nenin 34.9, sikur që shihet më lartë.

Duke e bërë këtë, ata kanë vepruar papërgjegjshëm dhe kanë shkakuar një dëm material të konsiderueshëm të përshkruar në faqet 28/29.

E. Dënimi

Kur e cakton dënimin penal, Gjykata duhet të ketë parasysh që të dy, qëllimin e përgjithshëm të dënimit për të shlytur veprimet shoqërore të rrezikshme duke i frenuar të tjerët nga kryerja e veprave të tilla penale, dhe qëllimin specifik që të parandalojë kryesin nga përsëritja e veprës. Në rastin konkret, Trupi Gjykses ka ardhur deri te konkluzioni se vetëm duke e aplikuar dënimin e caktuar të burgimit do të arrihet qëllimi i dyfishtë i përmendur më lartë.

Sjelljet e përmendura të tre të pandehurve Muje Ukaj, Nexhat Shatri dhe Blerim Svirca janë të ndryshme për kah origjina dhe peshë e tyre.

Svirca ka përfutur tepër shumë nga aktiviteti ilegal të cilit ai i ka kontribuar duke vepruar në dëm të ZPK, ndërsa dy tjerë, për një kuptim të interpretuar keq të lojalitetit, ku kanë vepruar papërgjegjshëm.

Dënimi i caktuar për secilin të pandehur, është menduar se do të funksionoj si një frenues i kryerjes së mëtejshme të veprimit penal.

Duke vendosur mbi zgjatjen e dënimit, Gjykata duhet të vlerësojë të gjitha faktorët rëndues dhe lehtësues, në bazë të nenit 64 paragrafi (1) të KPK.

Gjykata ka konsideruar si rrehanë lehtësuese për Muje Ukajn dhe Nexhat Shatrin gjendjen e vartësisë psikologjike ndaj Presidentit të Kosovës dhe personave që e rrethojnë ate, të cilit në njëfarë mënyre ata i shprehnin autoritet tepër të madh, gjë që ka penguar që ata të jenë objektiv.

Si rrehanë rënduese për Svirçën, Gjykata ka marr dëmin relevant të shkakuar dhe përfitimim gjegjësisë të fituar veçanërisht në lidhje me kushtet e jetesës në Kosovë. Shuma e të hollave që ka ardhur ilegalisht në llogarinë bankare të administruar nga Svirca është pasuri e madhe në Kosovë, e cila i përgjigjet pagesës për shumë vite të punës për një të punësuar të ndershëm dhe të cilën shumë njerëzit në Kosovë nuk e fitojnë gjatë tërë jetës.

Name: A Svirca final Judgment_EA

Translated by:TV 1- Phone: 4080

17, VR 18-34

Page: 34 of 36

Kjo ishte marr kundërligjshëm nga buxheti i Shtetit si një shenjë e arrogancës së egër.

Për veprë penale të Veprimtarisë së Papërgjegjshme Ekonomike duke e shkelur nenin 233 të KPPK, ligji parasheh dënimin me gjobë ose burgimin deri në tre vjet.

Duke marr në konsideratë rrethanat e rasis Gjykatata ka caktuar Muje Ukajt dhe Nexhat Shatrit dënimin me burgim për 2 vjet dhe 2 muaj.

Në bazë të nenit 41, paragraft 1 pikës 1, 42, 43 dhe 44 të KPK, dënimi kundër Muje Ukajt dhe Nexhat Shatrit është me kusht. Dënimi nuk do të ekzekutohet nëse të pandehurit nuk e kryejnë ndonjë veprë tjetër penale për një periudhë prej katër viteve;

Për veprë penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose Autoritetit duke shkelur nenin 339 të KPPK (1) dhe (3), ligji parasheh dënimin me burgim prej një deri në tetë vjet.

Duke i marr në konsideratë rrethanat e rasis, Gjykatata ka caktuar për Blerim Svirçën dënimin me burgim prej 3 viteve dhe 4 muaj.

Në bazë të nenit 73 të KPPK koha e kaluar në paraburgim prej 1 shtatorit 2005 gjerë më 21 janar 2006 do të përfshihet në gjatësinë e dënimit.

F. Gjërat e konfiskuara. Dorezania.

Në bazë të nenit 277 (4) të KPPK, anulohet dorëzania e caktuar ndaj Blerim Svirçës prej 60.000,00 euro në bazë të vendimit të gjykatësit të procedurës paraprake Nurul Khan të datës 20 janar 2006.

Në bazë të nenit 494 të KPPK e njëjta shumë e të hollave prej 60.000,00 euro konfiskohet dhe transferohet në thesarin e Kosovës.

G. Shpenzimet e procedurës penale

Në bazë të nenit 102 paragraft 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) personat e dënuar do të paguajnë shpenzimet e procedurës të cilat do të përcaktohen lidhur me numrin e seanceve të mbajtura, në 400,00 euro.

26 nëntor 2010

Kryetari i Trupit Gjykuës	Anëtarja e Trupit Gjykuës	Anëtari i Trupit Gjykuës
Francesco Florit	Karen Ausphag-Warg	Ramadan Gudaci

Procesmbajtësi
Stephen Parkinson

Name: *A Svirca final Judgment_EA*

Translated by: *IV 1 -* Phone: *4080*
17, VR 18-34
Page: *35 of 36*

KËSHILLA JURDIKE:

Palët kanë të drejtë të ankohen kundër këtij aktgjykimi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita kur kopja e aktgjykimit iu është dorëzuar në bazë të nenit 398 paragrafit 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), duke e dërguar ankesën Gjykatës Supreme të Kosovës nëpërmes të Gjykatës së Qarkut